



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 405, datë 1.6.2016

P Ë R

MIRATIMIN E STRATEGJISË SË STREHIMIT SOCIAL 2016-2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 34/1, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministritë, institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, të përmendura në tekstin e kësaj strategjie, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN

EGLANTINA GJERMENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Republika e Shqipërisë
Ministria e Zhvillimit Urban

Strategjia e Strehimit Social
2016-2025



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



United Nations
ALBANIA



*Empowered lives.
Resilient nations.*

PËRMBLEDHJE

Strategjia për Strehimin Social e Republikës së Shqipërisë është konceptuar në bazë të parimeve orientuese sipas të cilave duhet të ketë një paketë të përgjithshme të strehimit që të jetë e gatshme, e arritshme, e përbalueshme financiarisht dhe përshtatshme. Pikënisja për hartimin e vizionit, qëllimit dhe objektivave të strategjisë është nevoja urgjente që ka vendi për të rishikuar dhe përmirësuar kuadrin ekzistues institucional, ligjor dhe rregullator të sektorit të strehimit. Një shqetësim madhor është ofrimi relativisht i pakët i zgjidhjeve të strehimit për atë pjesë të popullsisë që nuk mund të përballojë financiarisht një shtëpi në tregun e hapur. Ky shqetësim merr edhe më shumë rëndësi nëse mbajmë në konsideratë se nga programet e tanishme të strehimit nuk përfitojnë grupet në pozita të pafavorizuara, karakteristikat demografike të të cilëve përbëjnë një pengesë të qartë për përballimin financiar dhe përfitimin nga programet e strehimit.

Sa më lart, **qëllimi kryesor i strategjisë** është: “Ofrimi i zgjidhjeve të gatshme, të arritshme, të përbalueshme dhe cilësore për strehim për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të hapur dhe, në veçanti, për familjet me tregues të pozitive të pafavorizuara që çojnë në përjashtim nga strehimi.” **Objektivat e strategjisë** janë kategorizuar sipas katër drejtimeve strategjike, të cilat përfshijnë (1) sigurimin e evidencës rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore; (2) përmirësimin ekuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator; (3) fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; dhe (4) zgjerimin dhe rorientimin e programeve të strehimit social.

Ky dokument është i organizuar në pesë kapituj. Në kapitullin e parë jepet një analizë e situatës së sektorit të strehimit në Shqipëri. Në kapitullin e dytë përshkruhet vizioni, qëllimi kryesor dhe objektivat e strategjisë dhe shpjegohen me hollësi katër parimet ku bazohen elementet kryesore të strategjisë, që do të thotë ekzistenca e një pakete strehimi që përcakton një banesë të gatshme, të arritshme, të përbalueshme dhe të përshtatshme. Në kapitullin e tretë, paraqiten objektivat dhe rezultatet. Në kapitullin e katërt jepet një informacion i përgjithshëm rreth burimeve financiare dhe alokimit të buxheteve. Në kapitullin e pestë përshkruhet plani i monitorimit dhe vlerësimit, të nevojshme për të ndjekur planin e zbatimit të strategjisë dhe për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjike.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. KUSHTET AKTUALE	5
1.1 Vështrim i përgjithshëm i ndryshimit të popullsisë dhe tregut të banesave në nivel kombëtar	5
1.2 Situata aktuale sipas fushave dhe sfidat	5
1.2.1 <i>Evidencë rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore</i>	<i>5</i>
1.2.2 <i>Kuadri ligjor, institucional, dhe rregullator</i>	<i>6</i>
1.2.3 <i>Instrumentet financiare për grupet në pozita të pafavorizuara</i>	<i>9</i>
1.2.4 <i>Qasja e programeve të strehimit social drejt grupeve në pozita të pafavorizuara</i>	<i>10</i>
II. VIZIONI, POLITIKAT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE	16
2.1 Vizioni	16
2.2 Qëllimi	17
2.3 Prioritetet strategjike	19
III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE REZULTATET	20
3.1 <i>Evidencë rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore</i>	<i>21</i>
3.2 <i>Kuadri ligjor, institucional, dhe rregullator</i>	<i>21</i>
3.3 <i>Fuqizimi i instrumentave financiare për grupet në pozita të pafavorizuara.....</i>	<i>23</i>
3.4 <i>Qasja e programeve të strehimit social drejt grupeve të pozita të pafavorizuara</i>	<i>24</i>
IV. BURIMET FINANCIARE, ALOKIMI I BUXHETEVE DHE MENAXHIMI I RRISKUT .	25
V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUERE	44
VI. REFERENCA	50

SHKURTESAT

ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
BE	Bashkimi Evropian
BKE	Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
DZHT	Drejtoria e Zhvillimit të Territorit
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
INSTAT	Instituti i Statistikave
KEKBE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën
KM	Këshilli i Ministrave
KNESS	Komiteti Ndërlidhës European për Strehim Social
MAS	Ministri e Arsimit dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MÇV	Ministria e Çështjeve Vendore
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBAM	Programi i Buxhetit Afatmesëm
RAT	Reforma Administrative dhe Territoriale
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
SSS	Strategjia e Strehimit Social
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

I. KUSHTET AKTUALE

1.1 Vështrim i përgjithshëm i ndryshimit të popullsisë dhe tregut të banesave në nivel kombëtar

Gjatë periudhës 1989-2011, numri gjithsej i popullsisë në Shqipëri ra me 12 për qind (nga 3.182.417 banorë në 2.800.138 banorë). Për më tepër, popullsia në fshat u pakësua me 36,3 për qind (nga 2.044.855 banorë në 1.301.601 banorë) ndërsa popullsia në qytet u rrit me 31,7 për qind (nga 1.137.562 banorë në 1.489.508 banorë) çka tregon një prirje të qartë urbanizimi. Në përgjithësi numri i ndërtesave për qëllime banimi u rrit me 55,1 për qind (nga 385.769 në 598.267) ndërsa numri i tyre në fshat u rrit me 22,1 për qind (nga 309.666 në 378.110) dhe numri i tyre në qytet u rrit me 189,3 për qind (nga 76.103 në 220.157) (Instat, 2012). Sipas INSTAT-it (2012), numri i ndërtesave për qëllime banimi në vitin 2011 ishte 598.267; 53,8 për qind e të gjitha njësive të banimit qenë përqendruar në qytet; ndërsa 46,1 për qind në fshat. Rreth 21,7 për qind e banesave qenë të pabanuara, nga të cilat 52,6 për qind në fshat. Afërsisht një e treta e të gjitha banesave në qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë qenë banesa të pabanuara dhe një e katërta e të gjitha banesave në qarqet Berat, Dibër dhe Lezhë qenë të pabanuara. Qarku Vlorë kishte përqindjen më të lartë të banesave të pabanuara, me 32,4 për qind, i ndjekur nga qarqet Gjirokastrë, Berat, Dibër dhe Lezhë. Qarku Durrës kishte përqindjen më të lartë të banesave të përdorura për qëllime dytësore dhe sezonale, i ndjekur nga qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Rreth 8,3 për qind e banesave përdoreshin për qëllime sezonale ose dytësore.

Gjatë vitit 2014, Ministria e Zhvillimit Urban, me mbështetjen e PNUD-it, realizoi dy studime të cilat u fokusuan në analizën e situatës së strehimit social¹ dhe vlerësimin e nevojave² për strehim social në Shqipëri. Studimet hodhën dritë mbi një sërë problemesh të cilat u synua të adresoheshin përmes Strategjisë së Strehimit Social. Konkretisht, u identifikuan një sërë sfidash të lidhura me evidencën e pakët rreth strehimit social and kapaciteteve vendore; kuadrin e pamjaftueshëm ligjor, institucional, dhe rregullator; instrumentet e kufizuara financiare për grupet e pafavorizuara; dhe nivelin e ulët të përfitimit nga programet e strehimit social të shtresave më të varfra. Më poshtë jepet një përshkrim i situatës sipas problematikave kryesore që u identifikuan.

1.2 Situata aktuale sipas fushave dhe sfidat

1.2.1 Evidencë rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore

Situata aktuale

Një nga pengesat kryesore për hartimin e politikave dhe programeve efektive të strehimit social është mungesa e të dhënave sistematike dhe analizave të cilat mbështeten në të dhëna. Si pari,

¹ Analiza e situatës u mbështet në rishikimin e literaturës ekzistuese, analizimin e të dhënave të grumbulluara nga Enti Kombëtar i Banesave rreth aplikantëve dhe përfituesve sipas programeve të strehimit social, dhe grumbullimin e të dhënave nga 39 njësi vendore – 27 bashki dhe 12 komuna – rreth programeve të strehimit social dhe kapaciteteve vendore. Analiza e situatës hedh dritë mbi kërkesën dhe ofertën për strehim social në nivel vendor, si edhe mbi sistemin e pikëzimit, sistemin e të dhënave, buxhetin për strehimin social, inventarin e banesave dhe truallit dhe nevojën e autoriteteve vendore për programe përngritjen e kapaciteteve.

² Vlerësimi i nevojave u mbështet në realizimin e intervistave me nëpunës shtetëror dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në tre bashki – Lezhë, Berat dhe Tiranë. Vlerësimi hodhi dritë mbi karakteristikat e aplikantëve dhe përfituesve, kapacitetet e njësive vendore për sigurimin e strehimit social, shpërndarjen e buxhetit për strehim social, transparencën dhe sigurimin e informacionit, si dhe marrëdhënien mes qeverisë vendore e asaj qendrore.

njësitë vendore nuk kanë një sistem të qëndrueshëm që u shërben për grumbullimin e të dhënave. Nga 27 bashki të cilat u pyetën rreth sistemit të grumbullimit të të dhënave në vitin 2014, 12 raportuan se nuk përdorin asnjë program për regjistrimin e të dhënave të aplikantëve dhe 15 bashki përdorin programin Excel. Së dyti, pjesa më e madhe e njësitë vendore nuk realizojnë analiza me qëllim identifikimin e nevojës për strehim si dhe identifikimin e burimeve lokale të cilat mund të mobilizohen me qëllim plotësimin e nevojave. Së treti, pjesa më e madhe e vëmendjes fokusohet në sigurimin e strehimit social; pas kësaj, pak dihet rreth impaktit që kanë programet e strehimit social në mirëqenien e familjeve. Zakonisht, specialistët e strehimit e përditësojnë informacionin kur u kërkohet t'i japin të dhëna këshillit bashkiak ose kur zbatohet një program i ri social për strehimin por përtej kësaj, të dhënat nuk përdoren për ndonjë qëllim tjetër (UNDP, 2014b).

Strategjia e Strehimit Social i kushton rëndësi të veçantë krijimit dhe forcimit të një sistemi të grumbullimit të të dhënave në mënyrë që drejtuesit vendorë të njohin nevojat për strehim dhe të hartojnë programe të përshtatshme mbështetur në burimet lokale. Njëkohësisht, qeveria qendrore të hartojë politika të cilat u përgjigjen nevojave në nivel vendor. Sistemi i të dhënave do të lejojë monitorimin dhe vlerësimin e situatës së strehimit social në kohë.

Sfidat

Sfida kryesore është njohja e qartë e ofertës dhe kërkesës për strehim social. Duhet të ngrihet një sistem i cili do të mundësojë grumbullimin dhe më tej analizimin e të dhënave në mënyrë periodike në secilën njësi vendore. Një tjetër sfidë është sigurimi i të dhënave në disa nivele – të dhëna që fokusohen në nevojën për strehim social, situatën e strehimit të grupeve të përjashtuara, si dhe asetet që zotërojnë njësitë vendore dhe mund të mobilizojnë me qëllim ofrimin e strehimit social. Kjo do të kërkojë krijimin e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e të dhënave dhe më tej forcimin e kapaciteteve vendore mbi mënyrën si të grumbullojnë, analizojnë, dhe më tej përdorin të dhënat. Këto hapa do t'i shërbejnë hartimit të politikave dhe programeve të mbështetura në evidencë.

1.2.2 Kuadri ligjor, institucional, dhe rregullator

Situata aktuale

Bazuar në Ligjin nr.9232³, programe sociale strehimi janë “programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekare” (neni 2, pika 3). Qeveria ka ngritur tre programe sociale strehimi: banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë. Krahas këtyre, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, kredive të subvencionuara, granteve të vogla dhe granteve të menjëhershme që kanë grupe të veçanta të synuara. Përfituesit e programeve sociale të strehimit duhet të përmbushin njërin prej kritereve të mëposhtme: nuk kanë në pronësi një banesë; zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;⁴ ose kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore (Ligji nr.9232, neni 4). Përzgjedhja e përfituesve mbështetet tek kushtet e tyre të jetesës si edhe tek rrethanat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Përparësi u jepet 15 grupeve, përfshirë familjet me një prind të vetëm, familjet e mëdha, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendqëndrim, jetimët, emigrantët e rikthyer, punëtorët migrues, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet rome, familjet egjiptiane dhe përfituesit e

³Datë 13.5.2004, Për programet sociale të strehimit. Përshkrimi i programeve sociale të strehimit mbështetet tek Ligji nr.9232.

⁴Normat e strehimit vendosen me Vendimin nr.814. Normat e strehimit përfshijnë dy komponentë: sipërfaqja minimale e nevojshme për jetesën e një personi dhe numri i personave për dhomë. Për shembull, sipërfaqja minimale është 12,4 m². Kjo ndryshon sipas moshës. Në llogaritje luan rol edhe përkatësia gjinore, kur bëhet fjalë për numrin e dhomave. Për personat me aftësi të kufizuara ka dispozita të veçanta.

ndihmës ekonomike. Programe të ndryshme u drejtohen grupeve të ndryshme.

Sipas ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ofrimi i strehimit është detyrë e autoriteteve vendore. Konkretisht, neni 72 përcakton se njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat "mbajnë përgjegjësi të plotë për kryerjen e funksioneve të tyre...në fushën e urbanistikës, rregullimit të territorit dhe strehimit [ndër të tjera]." Përgjegjësia e ofrimit të strehimit social ndahet midis qeverisë qendrore dhe njërive vendore. Pushteti qendror është përgjegjës për: krijimin e një programi strehimi afatgjatë; shpërndarjen e fondeve për zbatimin e programeve sociale të strehimit; përcaktimin e rregullave për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët; mbledhjen e të dhënave për administrimin e kërkesave për strehim; zhvillimin e një inventari të dhënash në nivel kombëtar; përcaktimin e kostos mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave; përcaktimin e kriterëve për investimin ose blerjen e banesave me kosto të ulët, të cilat financohen nga buxheti i shtetit; dhe mbikëqyrjen e investimeve për strehimin social, të financuara ose bashkë-financuara nga qeveria.

Autoritetet vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim; krijimin e programeve dhe projekteve afatmesme dhe afatgjata; ofrimin e truallit të lirë për ndërtim; paraqitjen e kërkesave për financime, investime dhe subvencione të qeveria qendrore; zhvillimin dhe administrimin e një inventari të dhënash; përcaktimin e kostos maksimale të ndërtimit të banesave; ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira; si dhe informimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban në lidhje me ecurinë e programeve të strehimit. Njësitë vendore duhet të krijojnë një plan strehimi afatgjatë që të përfshijë burimet financiare, nevojat për strehim dhe, ndër të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga programe të ndryshme strehimi. Njësitë vendore janë gjithashtu përgjegjëse për administrimin e kërkesave për strehim social dhe përcaktimin e grupeve që do të kenë përparësi. Këshilli bashkiak miraton sistemin e vlerësimit me pikë.⁵

Administratorët socialë, pjesë e Zyrës së Ndihmës Ekonomike, verifikojnë gjendjen financiare të personave që bëjnë kërkesë. Më pas, personat që kanë bërë kërkesë informohen për rezultatet. Ata kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin brenda dhjetë ditëve dhe të kërkojnë një vlerësim të dytë. Transparenca duhet të jetë elementi kryesor i punës së nëpunësve të njërive vendore. Njësitë vendore duhet të japin informacion "të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të qartë dhe të lexueshëm, edhe nga individët që kanë probleme me shikimin" (neni 5/1). Informacioni që i ofrohet publikut duhet të përfshijë: llojin e programit social të strehimit të zbatuar në bashki, kushtet që duhet të përmbushin personat që bëjnë kërkesë, dokumentet e nevojshme, procesin e aplikimit dhe organin ankimor. Njësitë vendore duhet të publikojnë dhe të vënë në dispozicion sistemin e vlerësimit me pikë, si dhe duhet t'u ofrojnë ndihmë personave që hasin vështirësi në plotësimin e procesit të bërjes së kërkesës (p.sh., nuk dinë shqip ose kanë probleme me shikimin) (neni 5/1, pika 2).

Megjithatë, kuadri institucional ekzistues karakterizohet nga një sërë problematikash. Problemi i parë është i lidhur me rolet e paqarta të institucioneve të ndryshme që janë përfshirë në ofrimin e strehimit social. Një analizë paraprake e pesë roleve të lidhura me drejtimin, financimin, ofrimin, rregullimin dhe lehtësimin e strehimit në lidhje me programin e banesave sociale me qira, banesave me kosto të ulët, pajisjen e truallit me infrastrukturë, subvencionit për banesa tregoi se në disa raste këto role nuk janë të mirëpërcaktuara. Kjo në mënyrë të veçantë për rolin e lehtësimit, i cili i referohet mbështetjes/ngritjes së kapaciteteve, zbutjes së riskut, mbështetjes për politikën dhe

⁵Sistemi i vlerësimit me pikë është krijuar për t'u dhënë përparësi grupeve në pozita të pafavorizuara. Për shembull, njësitë vendore mund të vendosin t'u japin prioritet (d.m.th. t'u caktojnë pikë më të larta) jetimëve dhe jo personave me aftësi të kufizuara. Kjo ndikon në probabilitetin e përzgjedhjes së tyre; sa më i lartë të jetë numri i pikëve aq më i madh është probabiliteti që ata të përfitojnë strehim social.

kërkimin shkencor në sektorin e strehimit, edukimin dhe mbrojtja e konsumatorëve; ky rol nuk është përcaktuar.

Gjatë viteve 2004–2014, qeveria shqiptare ka miratuar një ligj, nëntë vendime (njëri prej të cilëve është përditësuar pesë herë dhe më pas është apeluar), tre udhëzime, dy urdhra dhe një akt normativ. Gjithashtu, është publikuar një material informues mbi mundësitë e strehimit për shtetasit shqiptarë të kthyer (pa datë) (UNDP, 2014). Analiza e kuadrit ligjor e realizuar nga një sërë institucionesh si Avokati i Popullit si dhe organizata ndërkombëtare sugjeron se duhet të ndërmerren një sërë hapash për të përmirësuar situatën aktuale të strehimit social, si përfshirja e komuniteteve romë dhe egjiptiane në sistemin e vlerësimit me pikë, rishikimi i të ardhurave mesatare – tavan dhe dysheme – që duhet të përmbushin familjet që aplikojnë në programet e strehimit social, njohja dhe trajtimi i rasteve me shumë aspekte të pozitive të pafavorizuara në sistemin e vlerësimit me pikë, krijimi i sistemit të monitorimit për të garantuar që informacioni ka cilësi të mirë, specifikimi i ofrimit të programeve për ngritje kapacitetesh për të ndihmuar nëpunësit vendorë të trajtojnë nevojat për informacion të grupeve në pozita të pafavorizuara, forcimi i sanksioneve për familjet që nuk respektojnë rregullat e programit të banesave me kosto të ulët dhe rritja e transparencës, forcimi i kapaciteteve të njësive vendore për të siguruar dhe për të menaxhuar fonde nga donatorët, zhvillimi i programeve për rritjen e kapaciteteve të njësive vendore për të hartuar një program afatgjatë strehimi, dhe zhvillimi i një inventari kombëtar që përfshin informacion si për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale dhe përdorimi i këtij informacioni për hartimin e programeve dhe politikave kombëtare (Avokati i Popullit, 2012; UNDP, 2014b). Analizat sugjerojnë edhe rishikimin e kuadrit ligjor në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet aktorëve në nivel qendror dhe vendor dhe forcimin e partneritetit publik-privat.

Autoritetet vendore kanë raportuar si problemin kryesor në ofrimin e strehimit social mungesën e fondeve për t'i zgjeruar programet sociale: njësitë vendore nuk sigurojnë fonde të mjaftueshme për strehimin social dhe kapacitetet fiskale të bashkisë janë të dobëta (UNDP, 2014b). Probleme të tjera përfshijnë: autoriteteve vendore u mungon përvoja për ofrimin e strehimit social; nuk kanë kryer ndonjë studim për të analizuar situatën; dhe kanë probleme sa i takon rregullimit të territorit. Bashkitë nuk kanë truall të pazënë ku të ndërtojë njësi banimi; ka konflikte për tokën; bashkitë nuk kanë një plan strehimi; pronat e bashkive nuk janë të regjistruara; autoritetet vendore nuk kanë tërhequr donatorë; dhe procedurat bankare janë të gjata dhe të kushtueshme. Gjithashtu, bashkitë raportojnë se mungojnë shoqëritë e ndërtimit ose mungon bashkëpunimi me shoqëritë e ndërtimit, gjë e cila çon në mosshfrytëzimit e burimeve vendore. Një tjetër shqetësim i ngritur nga njësitë vendore është mungesa e bashkëpunimit me Entin Kombëtar të Banesave. Më të varfrit e të varfërve nuk i plotësojnë kriteret për programet e strehimit social; ata nuk i zënë besë autoriteteve vendore; dhe se legjislati nuk është i qartë lidhur me mënyrën se si duhen zgjidhur nevojat e të varfërve. Në mes të këtyre problemeve, njësitë vendore raportojnë se janë të gatshme të ofrojnë stimuj financiarë, siç janë lehtësitë fiskale, për shoqëritë e ndërtimit që investojnë në strehimin social (OSBE, 2012; UNDP, 2014b).

Mes problemeve kryesore që ua pengojnë pushtetit qendror dhe vendor plotësimin e ofertës janë vështirësitë në lidhje me faktorët e prodhimit të nevojshëm për strehimin social (truall, financa dhe ndërtim) por ndër to bën pjesë edhe përvoja e kufizuar me strehimin social. Rezultat i kësaj është, për shembull, se nuk arrihen komunitetet e varfra, përfituesit e synuar dhe në veçanti grupet në pozita të pafavorizuara, çka ka lidhje edhe me mungesën e njohurive të duhura për kërkesën. Në disa prej shkaqeve që përbëjnë bazën e vështirësive sa i takon gjetjes dhe përdorimit të truallit për banesa bëjnë pjesë mungesa e trojeve të lira dhe konfliktet mbi tokën të cilat lindin nga administrimi i dobët i tokës. Në veçanti problem janë financat, duke qenë se ka shumë pak fonde shtetërore të gatshme, çka kryesisht shpjegohet me bazën e dobët fiskale si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor, mundësi shumë të kufizuara për të përdorur fonde (të donatorëve), administrim i dobët i

tokës dhe sisteme të dobëta të pronave dhe bashkëpunim i kufizuar midis qeverisë, bankave dhe familjeve kur bëhet fjalë për strehimin social. Hartimin e planeve dhe politikave adekuata të strehimit në të gjitha nivelet e pengon edhe mungesa e përvojës sa i takon të kuptuarit të sfidës së strehimit social. Këtë proces e pengojnë edhe transparenca e informacionit, si edhe e drejta për marrjen e informacionit dhe regjistrimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave (për shembull, bazat e të dhënave në formë aplikacioni për strehimin social) si edhe sistemet e monitorimit.

Bashkitë dhe komunat shprehin vullnetin të bashkëpunojnë me Entin Kombëtar të Banesave dhe shoqëritë e ndërtimit për të zgjidhur problemin e strehimit. Disa nga sfidat me të cilat ato përballen, si kalimi i të drejtave të pronësisë, kërkojnë ndërhyrjen e pushtetit qendror. Por ka edhe disa dallime. Banesat kanë më tepër të ngjarë të shemben ose të jenë në rrezik shembjeje në zonat rurale. Për më tepër, banesat në zonat rurale kanë më pak të ngjarë të përmbushin kushtet shëndetësore dhe sanitare. Zonat rurale e kanë më tepër problem arritjen e shërbimeve publike dhe sociale. Sidoqoftë, zonat rurale kanë më tepër të ngjarë të kenë truall të lirë në dispozicion. Sipërfaqja mesatare e tokës së lirë për komunat (duke ju referuar ndarjes së vjetër territoriale) është 77000 m²; ndërkohë që për bashkitë është 8366 m². Projektet e strehimit social duhet të kenë parasysh se banorët në fshat nuk i lënë pronat e tyre dhe të kërkojnë strehim diku tjetër; familjet preferojnë t'i ndërtojnë banesat në pronat e tyre. Autoritetet vendore në zonat rurale kanë më tepër të ngjarë të raportojnë nevojën për programe për ngritje kapacitetesh si edhe për programe që fokusohen në rritjen e mundësive për të marrë pjesë në të mirat dhe shërbimet publike, si arsimi dhe ujësjellës-kanalizimet (UNDP, 2014b).

Këto diferenca ndërmjet zonave urbane dhe rurale theksojnë rëndësinë e madhe që ka hartimi i programe sociale që mbështeten në një njohje të mirë të situatës lokale. Njëkohësisht ato kërkojnë integrimin e Strategjisë së Strehimit Social në Reformën Territoriale dhe Administrative (RTA) si dhe gërshetimin e Strategjisë së Strehimit Social me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV), 2015-2020 dhe Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS), 2015-2020 (shih më poshtë për ndërthurjen e Strategjisë së Strehimit Social me strategji dhe dokumente të tjera).

Sfidat

Sfida kryesore lidhet me përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator në mënyrë që ky kuadër të reflektojë situatën aktuale si dhe të çojë në krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin e sektorit të strehimit social. Në mënyrë specifike, duhet të rishikohen detyrat menaxhuese dhe bashkërenduese të institucioneve dhe organizatave të lidhura me sektorin e strehimit social, si Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Çështjeve Vendore, si dhe profilet e përfituesve në mënyrë që ata të jenë sa më gjithëpërfshirës. Duhet të punohet me qëllim bashkërendimin e përpjekjeve në nivel qendror dhe vendor në shpërndarjen e strehimit social. Bashkërendimi do të jetë kyç edhe në shpërndarjen e informacionit rreth programeve të ndryshme të strehimit social pasi shpesh informacioni nuk arrin grupet e përjashtuara. Një tjetër sfidë përbën krijimi i një mjedisi ligjor dhe institucional mbështetës për njësitë vendore në mënyrë që ato të fuqizohen dhe të zhvillojnë programe strehimi për të përmbushur nevojat lokale. Do të punohet për krijimin e partneriteteve ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë, përfshirjen e komunitetit në ofrimin e strehimit, si dhe ndërlidhjen e shërbimit të strehimit me shërbime të tjera sociale.

1.2.3 Instrumentet financiare për grupet në pozita të pafavorizuara

Situata aktuale

Një tjetër problem që karakterizon sektorin e strehimit është i lidhur me numrin e kufizuar të instrumenteve financiare të përballueshme për të varfrit. Impakti i riorientimit të programeve të

strehimit social drejt grupeve të pozita të pafavorizuara do të jetë i kufizuar nëse këto grupe nuk do të kenë qasje të mjaftueshme në instrumenta financiare. Për shembull, programi i banesave sociale me qira krahasuar me programin e banesave me kosto të ulët ka më shumë gjasa të ketë në fokus familjet me të ardhura të ulëta (UNDP, 2014a). Megjithatë, njerëzit që jetojnë afër ose nënkuqirin e varfërisë nuk mund ta përballojnë as këtë program (Avokati i Popullit, 2012). Apo vlera e bonusit të strehimit që i jepet një familje nuk pasqyron ndryshimin e rrethanave të saj, sip.sh. ndryshimin në madhësinë e familjes. Njëkohësisht, mobilizimi i aktorëve lokalë në sigurimin e strehimit do të kërkojë edhe hartimin e instrumenteve financiarë që stimulojnë përfshirjen e tyre. Si rezultat, fuqizimi i instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara duhet të përbëjë prioritet për Strategjinë e Strehimit Social. Në vende të tjera Europiane, aplikohen forma të ndryshme të instrumenteve financiare, si përjashtimi nga taksat (p.sh. taksat mbi pronën, taksat për pasurinë e patundshme), ofrimi i truallit për zhvilluesit e strehimit social me çmime nën normat e tregut, dhe ofrimi i bonuseve të strehimit të kushtëzuara sipas gjendjes ekonomike apo skemave plotësuese të qirasë për qiramarrësit.

Çështje tjetër e strehimit është kryesisht mospërputhja midis kërkesës dhe ofertës sa i takon vendndodhjes (banesat nuk janë të gatshme aty ku nevojiten) dhe sa i takon përballueshmërisë dhe arritshmërisë (programet ekzistuese janë të papërballueshme apo të papërshtatshme sa i takon modelit); për shembull, pronarët e tokës kanë nevojë për grante për përmirësim ose ngritje të objekteve të banimit, ose ka nevojë për shërbime për tokën. Jo të gjithë kanë nevojë për një produkt të gatshëm strehimi ku të hyjnë për të banuar—sidomos pronarëve të trojeve shpesh u intereson më mirë të marrin mbështetje për të hartuar zgjidhje të përshtatura për truallin e tyre. Forcimi i instrumenteve financiare do të krijojë më shumë mundësi për grupet në pozita të favorizuara; të zgjedhim midis alternativave të ndryshme në përputhje me kushtet e tyre. Megjithatë, ky hap, ashtu siç përshkruhet edhe më poshtë, duhet të realizohet së bashku me zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social drejt grupeve në pozita të pafavorizuara.

Strategjia për Strehimin Social propozon dy drejtime të ndryshme për strehimin social, por që përforcojnë njëri-tjetrin. Nga njëra anë, programet sociale të strehimit janë të nevojshme për familje që nuk mund të përballojnë strehimin me çmimet e tregut për shkak të kushteve social-ekonomike (pragu i të ardhurave). Programet aktuale për këtë qëllim janë programet e banesave me kosto të ulët dhe skemat e kredive të përballueshme hipotekare që mund të merren nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave. Këto programe po ecin shumë mirë dhe deri diku janë institucionalizuar nga EKB-ja. Nga ana tjetër, programet sociale të strehimit janë të nevojshme për ato familje të përjashtuara nga tregu i strehimit për shkak të treguesve të pozitave të pafavorizuara (p.sh. romët dhe egjiptianët, gratë e abuzuara, jetimët, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët dhe të moshuarit). Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004 parashikon një gamë të gjerë programesh, por zbatimi i tyre nuk ka ecur sipas parashikimeve dhe kapacitetet institucionale midis njësive të qeverisjes vendore kanë dallime të konsiderueshme.

Sfidat

Sfida kryesore është fuqizimi i instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara. Duke qenë se instrumentet aktuale nuk përmbushin nevojat e grupeve të përjashtuara, duhet të punohet për rishikimin e tyre. Kjo mund të përfshijë krijimin e instrumenteve të reja dhe/ose ristrukturimin e instrumenteve ekzistuese. Për këtë gjë, nevojitet një analizë e hollësishme e instrumenteve aktuale, rishikimi i instrumenteve që ekzistojnë në vendet Europiane dhe më gjerë, dhe përdorimi i gjetjeve për të informuar rishikimin e instrumenteve financiare. Ky proces do të kërkojë bashkëpunimin e një sërë aktorëve në nivel kombëtar dhe lokal.

1.2.4 Qasja e programeve të strehimit social drejt grupeve në pozita të pafavorizuara

Situata aktuale

Analizat e realizuara nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare kanë nxjerrë në pah nevojën e lartë për strehim social. Vetëm një përqindje e vogël e popullsisë shqiptare në nevojë për strehim kanë përfituar nga programet e strehimit social.

Numri i kërkuesve gjatë periudhës 2005-2014 për të gjitha programet e strehimit social së bashku është 35.011⁶ (UNDP, 2014b). Shumica e personave kanë bërë kërkesë në programin e banesave me kosto të ulët. Konkretisht, 64,99 për qind (n = 22.753) kanë bërë kërkesë për banesa me kosto të ulët, 30,94 për qind (n = 10.834) për banesa sociale me qira, 1,94 për qind për subvencione për banesa (n = 678), dhe 1,13 për qind për truall të pajisur me infrastrukturë (n = 395). Numri i personave që kanë bërë kërkesë për banesa me kosto të ulët është 2,1 herë më i lartë se i atyre që kanë bërë kërkesë për banesa sociale me qira; 33,6 herë më i lartë se i atyre që kanë bërë kërkesë për subvencione për banesa; dhe 57,6 herë më i lartë se i atyre që kanë bërë kërkesë për truall të pajisur me infrastrukturë. Bashkitë me numrin më të madh të kërkuesve janë Tirana, Elbasani, Korça, Durrësi, Fieri, Vlora, Shkodra, Kuçova, Lezha dhe Saranda. Bashkitë me numrin më të vogël të kërkuesve janë Leskoviku, Roskoveci, Divjaka, Ura Vajgurore, Orikumi, Maliqi, Patosi, Burreli, Tepelena (*po aty*). Ndërkohë, numri i përfituesve në programet e banesave sociale gjatë periudhës 2005-2014 është 5.021⁷ (UNDP, 2014b, f. 22). Me fjalë të tjera, nga programet e strehimit social kanë përfituar 14,34 për qind e kërkuesve. Konkretisht, 2,68 për qind (n = 291) e kërkuesve kanë përfituar banesa sociale me qira; 17,62 për qind (n = 4.009) e kërkuesve kanë përfituar banesa me kosto të ulët; dhe 88,64 për qind (n = 601) e kërkuesve kanë përfituar subvencione për banesa. Numri i përfituesve të programit të pajisjes së truallit me infrastrukturë është 0. Të dhënat tregojnë se numri më i madh i përfituesve (dhe kërkuesve) është për programin e banesave me kosto të ulët, ndërsa, përqindja më e lartë e përfituesve është në programin e subvencioneve për banesa. Ka një kërkesë të madhe për banesa sociale me qira. Vetëm 2,68 për qind e kërkuesve kanë përfituar nga ky program (*po aty*). Tabela 1 paraqet numrin e kërkuesve dhe përfituesve sipas programeve.

Tabela 1: Kërkuesit dhe përfituesit, sipas programeve
Burimi: UNDP (2004b)

Programi	Numri i kërkuesve	Numri i përfituesve	% e përfituesve
Banesat sociale me qira	10.834	291	2,7
Banesat me kosto të ulët	22.753	4.009	17.62
Subvencionet për banesa	678	601	88,64
Pajisje e truallit me infrastrukturë	395	0	-
Gjithsej	35.011	5.021	14.34

Një studim i kryer nga UNDP (2014b) në 27 bashki tregon se numri i personave të pastrehë⁸ shkon nga 0 deri në 1.985 ($M = 283,88$, $SD = 443,68$). Gjithsej, autoritetet e qeverisjes vendore çmojnë se ka 7.381 persona të pastrehë. Ndërkohë, numri i kërkesave për të gjitha programet e strehimit social

⁶Të dhënat janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave. Në analizë janë përfshirë 45 bashki.

⁷Në analizë janë përfshirë 40 bashki.

⁸Autoriteteve vendore iu kërkua të jepnin një çmuarje të numrit të individëve të pastrehë. Në këtë shifër përfshihet numri i individëve që kanë bërë kërkesë për strehim social si edhe numri i individëve që nuk kanë bërë kërkesë për shumë arsye, për shembull ngaqë nuk kanë informacion për programet e strehimit social ose ngaqë nuk i përmbushin kriteret e vendosura me ligj (p.sh., familjet janë tepër të varfra dhe nuk mund të përfitojnë banesa me kosto të ulët).

shkon nga 2 deri në 1.480 ($M = 164,47$, $SD = 348,05$). Gjithsej, autoritetet e qeverisjes vendore çmojnë se ka 2.796 kërkesa. Numri i personave të pastrehë është 2,64 herë më i lartë se numri i personave të pastrehë që bëjnë kërkesë për strehim social. Për këtë mospërputhje mund të ketë shumë arsye. Për shembull, të pastrehët mund të mos jenë të informuar se si të përfitojnë nga banesat sociale apo si të regjistrohen për to, ose nuk i përmbushin kriteret, ose nuk kanë besim tek autoritetet e qeverisjes vendore. Tabela 2 paraqet numrin e kërkesve dhe përfituesve sipas grupeve.

Tabela 2: Kërkesit dhe përfituesit, sipas grupeve
Burimi: UNDP (2014b)

Grupi	Numri i kërkesve (familje)	Numri i përfituesve (familje)	Përqindja ⁹ e përfituesve
Familje me kryefamiljare femër	739	138	18,7%
Familje me një prind të vetëm	329	122	37,1%
Familje të mëdha	376	96	25,5%
Të moshuar	197	50	25,4%
Persona me aftësi të kufizuara	541	73	13,5%
Çifte në moshë të re	901	362	40,2%
Familje që kanë ndryshuar vendqëndrim	91	26	28,6%
Jetimë	86	4	4,7%
Emigrantë të rikthyer	129	36	27,9%
Punëtorë migrues	91	28	30,8%
Azilkërkes	1	0	0,0%
Anëtarë të familjeve të oficerëve të rënë në krye të detyrës	4	0	0,0%
Viktima të dhunës në familje	6	0	0,0%
Familje rome	43	16	37,2%
Familje egjiptiane	365	41	11,2%
Përfitues të ndihmës ekonomike	738	168	22,8%
Grupe të tjera	223	80	35,9%

Të dhënat tregojnë se përqindja më e lartë e përfituesve i përket grupit të çifteve të reja. 40 për qind e çifteve të reja që kanë bërë kërkesë në programet e strehimit social kanë përfituar nga programet. Ndërkohë, përqindja më e ulët e përfituesve u përket grupeve të jetimëve, egjiptianëve dhe familjeve me kryefamiljare femra. Për shembull, vetëm 11 për qind e egjiptianëve që kanë bërë kërkesë në programet e strehimit social kanë përfituar nga programet. Edhe pse numri i familjeve egjiptiane që kanë bërë kërkesë për strehim social është më i lartë se i familjeve rome (365 kundrejt 43), përqindja e përfituesve është më e ulët (11 kundrejt 37 për qind). Me fjalë të tjera, vetëm 11 për qind e familjeve egjiptiane që kanë bërë kërkesë në programet e strehimit social kanë përfituar nga programet. Ndërkohë, kjo shifër për familjet rome është 37. Mirëpo, numri i familjeve egjiptiane që kanë përfituar strehim social është më 2,56 herë më i lartë se i familjeve rome (41 kundrejt 16 përfitues). Përqindja e familjeve me kryefamiljare femra që kanë përfituar strehim social është e ulët. Edhe pse ky është njëri prej grupeve me numrin më të madh të kërkesave, përqindja e përfituesve është më pak se 20 për qind. Përqindja e jetimëve që kanë përfituar strehim social është shumë e ulët. Vetëm 4,65 për qind e kërkesve (4 nga 86 gjithsej) kanë përfituar nga një program i strehimit

⁹Përqindja e përfituesve është llogaritur duke pjesëtuar numrin e përfituesve me numrin e atyre që kanë bërë kërkesë.

social.

Programet e strehimit social tërheqin familjet me të ardhura mesatare 6 deri në 8 herë më të larta se kufiri i varfërisë¹⁰ (UNDP, 2014a). Një prej programeve më të mëdha (programi me banesa me kosto të ulët) nuk është i përballeshëm për të varfrit; për këtë arsye, të varfrit nuk përfitojnë nga ky program. Gjithashtu, procedurat bankare janë tepër të gjata dhe të kushtueshme; nëpunësit e njësive vendore dhe punonjësit e bankave shpesh u japin përparësi miqve; dhe nëpunësit e njësive vendore i nxisin individët të bëjnë kërkesë për strehim social edhe nëse këta nuk i përmbushin kriteret e vendosura me ligj. Programi i banesave sociale me qira ka më shumë gjasa të ketë në fokus familjet me të ardhura të ulëta. Por megjithatë, njerëzit që jetojnë afër ose nën kufirin e varfërisë nuk mund ta përballojnë këtë program. Përveç kësaj, programi i banesave sociale me qira nuk trajton nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Programi më i vogël është ai i subvencioneve të strehimit. Subvencionet e strehimit shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Nuk ka ndonjë rregull për të dekurajuar varësinë ndaj programit. Subvencionet e strehimit jo gjithmonë përdoren nga grupet në pozita të pafavorizuara për shkak të diskriminimit që hasin nga pronarët e apartamenteve (*po aty*).

Këto rezultate sugjerojnë se programet e strehimit social duhet të zgjerohen më tej për të përmbushur kërkesat e grupeve në nevojë. Njëkohësisht, programet e strehimit social duhet të riorientohen drejt shtresave në pozita të pafavorizuara. Deri tani, pjesa më e madhe e burimeve janë alokuar në përfitim të shtresës së mesme. Ndërkohë që mbështetja e kësaj shtrese është e rëndësishme, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe grupeve më të varfëra. Strategjia e Strehimit Social i adreson të dyja çështjet. Strategjia parashikon rritjen e përfituesve dhe zgjerimin e programeve që kanë më shumë gjasa të targetojnë grupet në pozita të pafavorizuara.

Sfidat

Një nga sfidat kryesore është riorientimi i programeve sociale drejt grupeve në pozita të pafavorizuara. Vëmendja duhet të përqëndrohet tek grupet e përjashtuara të cilat deri tani kanë patur shumë pak gjasa për të përfituar nga programet e strehimit social. Kjo kërkon një mobilizim të burimeve vendore por edhe një ndryshim të shpërndarjes së buxhetit. Deri tani, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për strehim është alokuar për një prej programeve nga i cili ka më shumë gjasa të përfitojë shtresa e mesme. Ky ndryshim kërkon vullnet politik por edhe një rritje të ndërgjegjësimit të njësisë vendore për të alokuar burime në mbështetje të programeve të strehimit social. Një tjetër sfidë është vënia në funksion e programit të pajisjes së truallit me infrastrukturë – program i cili deri tani nuk është zbatuar.

Ndërthurja me strategji të tjera

Hartimi i Strategjisë së Strehimit Social është mbështetur në përparësitë afatgjata kombëtare të zhvillimit të Shqipërisë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet (SKZHI), 2015-2020. Një nga objektivat e SKZHI-së është që të “garantojë qasje të barabartë në mundësitë sociale dhe ekonomike për të gjitha grupet dhe individët në shoqërinë tonë.”¹¹ Ky objektivi lidhet me pritshmërinë që Republika e Shqipërisë do të krijojë një sistem të krahasueshëm me BE-në për monitorimin dhe raportimin mbi gjendjen e përfshirjes sociale dhe varfërisë, do të forcojë dhe ndërtojë kapacitetet e administratës publike dhe autoriteteve lokale për zbatimin dhe raportimin mbi procesin e përfshirjes sociale dhe do të krijojë një njësi efikase për të bashkërenduar zbatimin e masave dhe për të raportuar mbi përparimin e përfshirjes sociale. Politikat e përfshirjes sociale duhet të bëhen pjesë përbërëse e veprimtarive të rregullta të institucioneve përkatëse në të gjitha nivelet. Proceset që do të kryhen do të mbështeten në njohuritë dhe praktikën e mira të krijuara në

¹⁰Kufiri i varfërisë është 4891 lekë për frymë në muaj (INSTAT, 2013).

¹¹Shih: http://shtetiweb.org/ep-content/uploads/2014/06/NSDI_2014-2020_version_June-2013.pdf.

vendet evropiane, si dhe në përvojën e Republikës së Shqipërisë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare.

SKZHI ka identifikuar një sërë sfidash në sektorin e strehimit social. Sfidat përfshijnë (a) nevojën për të siguruar një përqindje më të madhe të popullsisë shqiptare që të ketë qasje në një strehim të përballueshëm dhe që nuk përjashtohet nga strehimi për shkak të faktorëve të ndjeshmërisë; (b) nevojën për të zhvilluar më tej dhe më pas zbatimin e një politike të integruar për strehim social me target grupe me të ardhura të ulëta dhe grupe vulnerabël; (c) nevojën për të siguruar një mjedis politikash të favorshme për disponueshmërinë, aksesin dhe përballueshmërinë minimale për standardet e banimit; (d) krijimin e një Regjistri Kombëtar të Banesave; (e) rritjen e aksioneve të strehimit social për pjesët më vulnerabël dhe të përjashtuara të shoqërisë; (f) përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian si dhe për grupet e tjera të përjashtuara ose të pafavorizuara.

Zbatimi i Strategjisë së Strehimit Social do të gërshetohet me strategji dhe dokumenta të tjerë, në mënyrë të veçantë me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2015-2020 dhe Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale (DPPS) 2015-2020.

SNDQV-ja përcakton se NJQV-të “kanë përgjegjësi për planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimin duke angazhuar fondet e tyre, buxhetin e shtetit, fondet e donatorëve apo të partneriteteve private-publike për programet e strehimit social, strehimin me kosto të ulët apo për infrastrukturën e tokës” (p. 12). SNQV-ja thekson rëndësinë e mbështetjes në partneritetin publik-privat “si një mundësi e NJQV-ve për financimet private me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të infrastrukturës publike dhe aseteve vendore” (p. 12). Njëkohësisht, ajopërcakton se bashkitë do të hartojnë plane 10-vjeçare të strehimit social si dhe do të planifikojnë fonde për strehimin social. Qeveria qendrore do të ofrojë mbështetje sidomos në forcimin e kapaciteteve të bashkive për administrimin e kërkesave për strehim social dhe menaxhimin e stokut të banesave sociale.

Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale (DPPS) përcakton krijimin e një sistemi për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në disa fusha, duke përfshirë varfërinë dhe mbrojtjen sociale, punësimin dhe sipërmarrjen, arsimin dhe trajnimin, shëndetin, strehimin e nevojat bazë, si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtave e njeriut. Pjesë e këtij dokumenti është nxitja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në mënyrën se si matet dhe përdoret përfshirja sociale për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale. Një sërë treguesish janë hartuar me qëllim monitorimin e performancës së sektorit të strehimit, si përqindja e personave që nuk kanë asnjë strehim në raport me popullatën e përgjithshme, përqindja e familjeve pa qasje në ujë të rrjedhshëm dhe energji elektrike, dhe përqindja e familjeve ku shpenzimet e përgjithshme të strehimit e kalon 50 përqind të të ardhurave të përgjithshme të disponueshme të familjes.


Strategjia për strehimin social kundrejt anëtarësimit në BE

Strategjia do të zhvillohet duke pasur parasysh rregulloret e BE-së.¹² Në kontekstin evropian, strehimi social kuptohet në mënyra të ndryshme dhe pavarësisht se mungon një përkufizim i përbashkët, strehimi social në përgjithësi përkufizohet në lidhje me: pronësinë, ofruesin e shërbimit, përfituesit dhe marrëveshjet e financimit. Si rezultat, përkufizimi i strehimit social për Shqipërinë

¹²Ky seksion mbështetet në një shënim nga Drejtoria e Përgjithshme për Politikën e Brendshme, Departamenti i Politikave A: Politikat Ekonomike dhe Shkencore, Punësimi dhe Çështjet Sociale, në Parlamentin Evropian. IZA, 2013. Strehimi social në Bashkimin Evropian. Departamenti i Politikave: Politikat Ekonomike dhe Shkencore.

zërthehet më tej në këtë politikë në lidhje me këto 4 dimensione. Figura 2.1 tregon përqindjen e strehimit social në vendet e BE-së.

Figura 1: Raporti i strehimit social në vendet e BE-së



Burimi: IZA, 2013 mbështetur në Cecodhas, 2012

Në kontekstin e BE-së strehimi social në përgjithësi shikohet si një mision me interes të përgjithshëm, me objektivin për të rritur ofrimin e strehimit të përballueshëm dhe për grupe specifike të synuara, mbështetur në kushtet social-ekonomike dhe/ose praninë e pozitive të pafavorizuara. Sidoqoftë, brenda BE-së përdoren modele të ndryshme për të arritur në ofrimin e strehimit social. Në përgjithësi këto përshkruhen si modele "për të gjithë" ose "me grupe të synuara". Modeli i strehimit "për të gjithë" e shikon strehimin si një përgjegjësi publike dhe, për rrjedhojë, e gjithë popullsia duhet të ndihmohet me strehim të përballueshëm dhe të denjë. Ky model është zbatuar në veçanti në periudhën komuniste, megjithëse edhe disa vende në Evropën Veriore dhe Perëndimore nuk vendosën kufizime për "grupet e synuara" për disa dekada dhe promovuan dhe mbështetën strehimin social në mënyrë efikase për të gjitha nivelet e shoqërisë. Vendet në veri dhe perëndim të BE-së ku mbizotëronte strehimi "për të gjithë" karakterizohen nga një përqindje e lartë e banesave sociale në stokun e përgjithshëm të banesave.

Aktualisht në kontekstin e BE-së mbizotëron modeli "**me grupe të synuara**" ku zbatohen dy nënmodele shumë të ndryshme. Modeli me grupe të synuara mund të jetë "gjeneralist" kur kriteri i vetëm që lidhet me fokusin "e synuar" janë të ardhurat familjare. Modeli i synuar mund të përqaset dhe me metodën "reziduale" (me grup të synuar), ku grupin e synuar e përcakton një grup treguesish të pozitive të pafavorizuara. Në përgjithësi modelet "reziduale" (me grup të synuar) të strehimit janë relativisht të vogla sa i përket madhësisë, sepse ato zbatohen për një grup shumë specifik dhe shpesh relativisht të vogël. Kurse modelet më "gjeneraliste" të strehimit zënë një vëllim mesatar, sepse kanë si objektiv një pjesë shumë më të madhe të shoqërisë.

Ligji për strehimin social në Shqipëri lë hapësirë për të zhvilluar një model "me grupe të synuara" të strehimit social, ku përfshihen edhe qasjet "gjeneraliste", edhe ato "reziduale", duke qenë se ai parashikon programe të ndryshme strehimi. Programi i "banesave sociale me kosto të ulët" në Shqipëri mbështetet në një qasje më gjeneraliste pasi ai bazohet kryesisht vetëm tek niveli i të ardhurave, megjithëse merren në konsideratë disa tregues të tjerë të pozitive të pafavorizuara. Programet e tjera në Shqipëri, si banesat sociale me qira, trualli i pajisur me infrastrukturë dhe programet më të vogla, duke përfshirë bonuset e strehimit, subvencionet e qirasë, grantet e menjëhershme dhe të vogla, mbështeten në kriteret kualifikuese më specifike dhe mund të shkojnë drejt modelit rezidual.

Deri më sot, zbatimi i strehimit social ka qenë shumë më i konsiderueshëm për programin e "banesave sociale me kosto të ulët". Prandaj, kjo strategji vë një theks të veçantë jo vetëm në përfitimin e familjeve për shkak të kushteve social-ekonomike, por gjithashtu (dhe në rritje) mbi bazën e pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim nga strehimi. Brenda kontekstit të BE-së, tensioni ndërmjet të drejtave sociale dhe ekonomike në politikën sociale ka çuar në shumë debate brenda BE-së. BE-ja ka monitoruar nga afër konkurrencën e padrejtë në tregun e banesave, sidomos në vendet që ndjekin një qasje me strehim për të gjithë. BE-ja nuk e lejon konkurrencën e mbrojtur në tregun e banesave, por nga pikëpamja e rolit të strehimit social lidhur me mbrojtjen sociale, pozitave të pafavorizuara dhe solidaritetin krahasuar me konkurrencën në treg, tashmë strehimi social pranohet si Shërbim me Interes të Përgjithshëm Ekonomik (SGEI). Kështu që qeverisja qendrore dhe vendore kanë ende hapësirë për të nxitur ofrimin e strehimit social nga partnerët "e preferuar", por brenda një fushe veprimi të kufizuar dhe të përcaktuar qartë.

Përkufizimi i strehimit social dhe modeli i ofrimit të tij

Strehimi social në kontekstin evropian përkufizohet në lidhje me pronësinë, ofruesin e shërbimit, përfituesit dhe masat e financimit. Në kontekstin shqiptar dhe në kontekstin e kësaj strategjie për strehimin social "*strehimi social është një alternativë strehimi që mund të ofrojë dhënien me qira ose pronësinë e banesës, e cila ofrohet nga qeverisja vendore ose sektori privat për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të blejnë një shtëpi me çmimet e tregut dhe/ose për familjet e përjashtuara nga tregu i banesave për shkak të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim. Financimi ofrohet nga qeverisja qendrore dhe mund të plotësohet nga buxhetet e qeverisjes vendore. Përveç kësaj, agjencitë (gjysmë) shtetërore, si Enti Kombëtar i Banesave, ofrojnë masa të tjera financimi për të plotësuar strehimin social.*" Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004 për strehimin social përcakton përkufizimin ligjor të pronësisë së banesës sociale, grupit të synuar, subvencioneve dhe të kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve.

Krahasuar me modelet e ofrimit të strehimit social në BE, kjo strategji e strehimit social në Shqipëri ofron një zgjedhje të qartë për modelin "me grupe të synuara" krahasuar me modelin "strehim për të gjithë". Ky model është në harmoni të plotë me shumicën e vendeve të BE-së të anëtarësuara së fundmi, ku mbizotëron qartazi përdorimi i modelit të qasjes "me grupe të synuara". Meqenëse sfida e strehimit social është e vështirë dhe tregu i banesave shfaq pengesa të qarta në lidhje me gjendjen social-ekonomik, por edhe lidhur me përjashtimin për shkak të pozitave të pafavorizuara, strategjia propozon dy programe madhore. Një program ka të bëjë me fokusimin në modelin "gjeneralist me grupe të synuara", ku gjendja social-ekonomike (të ardhurat) përbën faktorin kryesor përcaktues. Programi tjetër ka të bëjë me një fokusim më të veçantë në qasjen e modelit "rezidual" (me grupe të synuara), ku faktorët kryesorë përcaktues janë treguesit e qartë të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim nga strehimi.

II. VIZIONI, POLITIKAT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Në këtë kapitull të strategjisë përshkruhen bazat e përgatitjes së planit të zbatimit. Në të përshkruhet vizioni, qëllimi kryesor dhe objektivat e strategjisë dhe shpjegohen me hollësi katër parimet ku bazohen elementet kryesore të strategjisë. Sipas këtyre parimeve, duhet të ketë një paketë të përgjithshme të strehimit që të jetë e gatshme, e arritshme, e përballeshme financiarisht dhe përshtatshme.

2.1 Vizioni

Përfshirja sociale dhe ekonomike nëpërmjet ofrimit të alternativave të strehimit të cilat janë të gatshme, të arritshme, të përballeshme dhe të përshtatshme, për më shumë se 60% të popullsisë

shqiptare e cila nuk ka mundësi financiare të përballojë strehimin në treg dhe në veçanti grupet të cilat janë në pozita të pafavorizuara.

Formulimi i vizionit mbështetet në tre parimet e mëposhtme:

- Nevojat për strehim të familjeve me të ardhura të ulëta dhe, sidomos, të grupeve në pozita të pafavorizuara (siç përcaktohet në ligj) përbëjnë prioritet.
- Politika e strehimit social është rezultat i një qasjeje të integruar të çështjes së strehimit mbështetur në parimet e gatishmërisë, arritshmërisë dhe përballueshmërisë të alternativave për strehim cilësor.
- Sektori i strehimit ndërvepron me sektorë të tjerë, si për shembull arsimit, shëndetësinë, punësimin, dhe mbrojtja sociale, dhe ndikon mirëqenien sociale dhe ekonomike të familjeve.

2.2 Qëllimi

Qëllimi i strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës së 25,000 familjeve shqiptare me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara që vuajnë nga përjashtimi social përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

Me qëllim arritjen e vizionit të strategjisë dhe përcaktimin e qëllimit dhe të objektivave të saj është përcaktuar një grup parimesh udhëzuese. Këto parime udhëzuese kryesore në një sektor strehimi social funksional janë *gatishmëria, përballueshmëria dhe arritshmëria*. Një parim i katërt, *mjaftueshmëria e paketës së përgjithshme të strehimit*, është parashikuar për të testuar nëse të tre parimet e tjera janë të integruara dhe mbështetin njëri-tjetrin, duke vënë theksin në garantimin se të tre parimet kryesore janë të qëndrueshme. Arritja e parimeve udhëzuese kryesore kërkon të dhëna të besueshme rreth stokut të banesave, nevojave për strehim, përfituesve të banesave, ofruesve të banesave dhe rreth mjeteve financiare në dispozicion. Është shumë e rëndësishme që të dhënat të jenë të sakta dhe aktuale, në mënyrë që të hartohen politika që mund të zbatohen konkretisht dhe me efikasitet. Përkufizimi i parimeve jepet në vijim.

Gatishmëria

Në kontekstin e strehimit social është qartazi e rëndësishme që banesat t'u jepen përfituesve të synuar, fakt që nënkupton se ka banesa të gatshme. Këto mund të jenë banesa ekzistuese ose të ndërtruara rishtazi, për sa kohë që këto opsione strehimi janë të përshtatshme për grupin e synuar dhe ndodhen në vendet ku nevojiten. Duhet bërë një dallim ndërmjet numrit të banesave sociale të dhëna në një bashki (të ndërtruara rishtazi ose të shndërruara në banesa sociale, shpesh ndërtesa dikur në pronësi të shtetit) dhe subvencionimeve të qirasë, të cilat u jepen familjeve që kanë gjetur një banesë në treg dhe u ofrohet vetëm subvencion. Si rezultat, kuptimi i gatishmërisë së strehimit social shkon përtej vënies në dispozicion të banesave. Ai mund të nënkuptojë gjithashtu edhe gatishmërinë e financimit për familjet që të gjejnë banesa në tregun e lirë (veçanërisht në mungesë të alternativave të mjaftueshme për strehim nga sektori publik). Gatishmëria e banesave është një çështje që lidhet në mënyrë specifike me vendndodhjen. Numri i barabartë i banesave dhe i familjeve që kanë nevojë për strehim në nivel kombëtar nuk do të thotë se mjafton ekzistenca e tyre. Mund të ketë dallim të madh midis vendit ku ndodhen shtëpitë dhe vendit ku duhet të jetojnë familjet.

Përballueshmëria

Strehimi i përballueshëm me cilësi të mirë është themeli i komuniteteve të qëndrueshme. Pasja e një shtëpie me kosto të përballueshme siguron stabilitet për familjet dhe efekte anësore pozitive, si

shëndet më i mirë, rezultate më të mira në shkollë për fëmijët etj. Nivelet e përballueshmërisë janë të ndryshme për tregjet e banesave me qira dhe banesave në pronësi. Grupeve me të ardhura shumë të ulëta dhe me të ardhura të mesme deri në të larta shpesh u ofrohen alternativat më të mira për të pasur një shtëpi në pronësi. Familjeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme mund t'u ofrohen si alternativë banesat me qira, me kusht që çmimet e banesave sociale me qira të jenë më të përballueshme sesa çmimet e tregut të lirë. Nivelet e pronësisë së banesës mund të luhaten nga zotërimi i një sipërfaqeje banese me shërbimet bazë (një truall që përfshin pronësinë e sigurt dhe marrjen e shërbimeve bazë) ose zotërimi i njësisë bazë të strehimit deri te pronësia e një banese të përfunduar. Kostot për këtë diapazon të shumëllojshëm të produkteve të strehimit ndryshojnë dhe sa më të larta të jenë kostot, aq më shumë subvencione ose grante kërkohen, duke supozuar se familjet mund të përballojnë vetëm vlerat e subvencionuara dhe jo çmimet e nivelit të tregut. Përballueshmëria mendohet të jetë rreth 25 deri në 33 për qind e të ardhurave mujore të familjeve, por e drejta për të marrë hua bankare kushtëzohet nga pasja e të ardhurave të sigurta dhe të rregullta. Përveç kësaj, është e rëndësishme që të shqyrtohet përballueshmëria me kalimin e kohës. Shumë pak familje mund të përballojnë blerjen e shtëpisë duke paguar të gjithë shumën njëherësh. Për rrjedhojë, pagesat mujore duhet të jenë të përballueshme, duke përfshirë jo vetëm shlyerjen e kredisë (p.sh. hipotekare ose subvencionet), por edhe kostot e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesës.

Arritshmëria

Në strehimin social arritshmëri quhet tërësia e rregullave dhe rregulloreve që u mundësojnë familjeve të kualifikohen dhe të përzgjidhen për strehim social. Kriteret e kualifikimit për strehim social duhet të jenë realiste për sa u përket grupeve të synuara. Identifikimi i grupeve të nënsynuara dhe vendosja e prioriteteve, si edhe vendosja e kuotave për grupet specifike të synuara, mund të rrisin arritshmërinë. Përdorimi i masave të veçanta të përkohshme (diskriminimi pozitiv apo favorizimi i një grupi që perceptohet se vuan nga diskriminimi) mund të përmirësojë arritshmërinë për grupet specifike të synuara. Kjo duhet trajtuar me kujdes dhe duhet shqyrtuar vazhdimisht me qëllim që të përshtatet kur është e nevojshme dhe që të shmangët krijimi i varësisë nga masat e veçanta. Marrja e strehimit social mbi bazën e kërkesës është më i zakonshëm në sektorë të maturuar të strehimit social me një stok të mjaftueshëm banesash sociale.

Përshtatshmëria e paketës së përgjithshme të strehimit

Ky parim mbështetet në një interpretim tërësor me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme të tre parimeve të parashtruara më sipër. Ekziston rreziku që gatishmëria, përballueshmëria dhe arritshmëria të vlerësohen në mënyrë teknokrate, së cilës i mungon një vlerësim solid i mjaftueshmërisë faktike të paketës së plotë të strehimit. Ky lloj shqyrtimi është thelbësor për arritjen e programeve dhe projekteve të qëndrueshme të strehimit. Gatishmëria duhet të garantohet jo vetëm për sa i përket numrit të banesave, por edhe në lidhje me vendndodhjen, llojin e banesave, përshtatshmërinë për grupin e synuar dhe parandalimin e diferencimit. Kjo është ajo që quhet përshtatshmëri e paketës. Sa i përket përballueshmërisë, elementet që shpesh anashkalohen përfshijnë faktin nëse mirëmbajtja është e përballueshme (qëndrueshmëri afatgjatë) ose nëse ofrohet mundësia për të marrë shërbimet bazë, si p.sh. energjia elektrike dhe gazi i lidhur me banesat (p.sh. a kanë banorët mundësi për të marrë gaz më të lirë, apo për gatimin përdorin energji elektrike që është më e kushtueshme). Sa i përket arritshmërisë, sistemi i regjistrimit për strehim duhet të sigurojë ose të mbështesë pjesëmarrjen në shërbime të tjera, si formimi profesional, shkolla, kujdesi shëndetësor dhe, në përgjithësi, hyrje në tregun e punës. Për rrjedhojë, parimi i fundit shërben për të garantuar një interpretim të drejtpeshuar, tërësor, të integruar dhe të qëndrueshëm të tre parimeve të tjera.

2.3 Prioritetet strategjike

Kjo strategji parashikon se ofrimi i alternativave përnjë strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm, dhe të përshtatshëm do të çojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së familjeve shqiptare me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, e në veçanti familjeve me pozita të pafavorizuara që vuajnë nga përjashtimi social.

Strategjia përcakton 4 prioritete strategjike të cilat do të çojnë në ofrimin e alternativave të strehimit. Këto prioritete strategjike janë si më poshtë:

Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave rreth strehimit social

Ky prioritet synon njohjen e qartë të kërkesës dhe ofertës për strehim përmes ngritjes së një sistemi që siguron njohuri të kërkesës dhe ofertës për strehim në mënyrë periodike në të gjitha njësitë vendore. Çdo njësi vendore do të ketë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të dhënave. Do të punohet me qëllim krijimin e disa niveleve të të dhënave: të dhëna rreth aplikantëve dhe përfituesve për strehim, të cilat do të regjistrohen në mënyrë sistematike, dhe të dhëna rreth situatës së grupeve në pozita të pafavorizuara për strehim. Njëkohësisht, të gjitha njësitë vendore do të identifikojnë burimet apo asetet që ato zotërojnë apo mund të sigurojnë në bashkëpunim me aktorë të nivelit qëndror dhe vendor me qëllim ofrimin e strehimit social. Ky prioritet do të çojë në sigurimin e evidencës me qëllim njohjen më të mirë të situatës dhe hartimin e programeve që adresojnë problemet dhe sfidat e identifikuara në çdo njësi vendore.

Forcimi i kapaciteteve vendore do të fokusohet në ngritjen e sistemit të të dhënave dhe trajnimin e specialistëve të strehimit. Në të 61 njësitë vendore do të krijohet një sistem i grumbullimit të informacionit rreth aplikantëve dhe përfituesve të strehimit social, dhe burimeve lokale të cilat mund të mobilizohen me qëllim ofrimin e programeve të strehimit social; do të realizohen analiza të cilat do të përdoren me qëllim shqyrtimin e situatës së strehimit të grupeve në pozita të pafavorizuara. Njëkohësisht, në të 61 njësitë vendore specialistët e strehimit do të trajnohen rreth ofrimin të shërbimit të strehimit.

Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve të pafavorizuara përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe institucional

Ky prioritet synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave menaxhuese dhe bashkërenduese të institucioneve dhe organizatave të lidhura me sektorin e strehimit social; krijimin e profileve përfshirëse të përfituesve; trajtimin e nevojave të grupeve në pozita të pambrojtura me fokus parashikime që trajtojnë diskriminimin pozitiv. Do të synohet gjithashtu bashkërendimi i përpjekjeve në nivel qëndror dhe vendor për 61 bashki në shpërndarjen e strehimit social dhe informacionit rreth programeve të ndryshme të strehimit social. Vëmendja do të përqëndrohet në krijimin e një mjedisi ligjor dhe institucional mbështetës për njësitë vendore. Në legjislacion do të përcaktohen disa elemente të reja, të cilat nuk janë aplikuar më parë në fushën e strehimit, siç janë format e ndryshme të partneritetit publik dhe privat si dhe përfshirja e komunitetit në ofrimin e strehimit, si dhe ndërlidhja e shërbimit të strehimit me shërbime të tjera sociale.

Konkretisht, rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional do të çojë në zgjerimin e grupit të përfituesve të strehimit social me rreth 20%. Qasja në informacion do të përmirësohet në të gjitha bashkitë. Do të krijohen partneritete publik-privat në 40% të njësive vendore. Do të zbatohen projekte të cilat do të fokusohen në përfshirjen e komunitetit në sigurimin e strehimit në 30% të njësive vendore. Njëkohësisht, do të realizohet ndërlidhja e shërbimit të strehimit me shërbime të tjera sociale në të gjitha njësitë vendore.

Rritja e numrit të përfituesve në pozita të pafavorizuara përmes zgjerimit të instrumenteve financiare

Ky prioritet synon fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara. Do të punohet për krijimin e kushteve për zhvillimin e institucioneve të reja financiare ose rristurimin e atyre ekzistuese në nivel qendror dhe vendor për të ofruar një gamë më të gjerë mundësish (modele) financimi për strehim, të cilat plotësojnë kushtet për të qënë të arritshme dhe të përballueshme nga përfituesit e synuar.

Të gjitha njësitë vendore do të kenë mundësi të përzgjedhin prej një game më të gjerë instrumentash. Ky prioritet do të çojnë në rritjen e numrit të individëve në pozita të pafavorizuara të cilat përfitojnë nga programet e strehimit social. Afërsisht, numri i individëve në pozita të pafavorizuara të cilat do të përfitojnë pas zgjerimit të instrumentave financiare do të rritet me 20%.

Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet zgjerimit dhe riorientimit të programe të strehimit social

Ky prioritet synon zgjerimin e programeve sociale ekzistuese të strehimit social si dhe riorientimin drejt programeve të cilat kanë më shumë gjasa të targetojnë grupet në pozita të pafavorizuara. Gjatë periudhës 2016-2019, numri i familjeve në pozita të pafavorizuara të cilat do të përfitojnë nga programet e strehimit social si rezultat i zgjerimit dhe riorientimit të programe do të rritet me 20% dhe ky numër në vitin 2025 do të shkojë 50%. Programet për strehimin do të orientohen kryesisht në subvencionet për qiratë e banesave sociale dhe bonuset e strehimit të cilat synojnë të adresojnë grupet e pafavorizuara, të cilat kanë të ardhura të ulëta apo nuk kanë të ardhura fare. Ky prioritet do të adresojë një prej shqetësimeve kryesore të ngritur nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kanë theksuar se gjatë periudhës 2005 – 2014 programet të cilat janë zbatuar nuk kanë targetuar shtresat më të varfëra. Do të punohet për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Gjatë periudhës 2016-2019, 150 familje Rome dhe Egjiptiane do të përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit. Deri në fund të vitit 2025, 500 familje Rome dhe Egjiptiane do të përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit. 100% e banesave të synuara do të rehabilitohen gjatë zbatimit të projekteve të eficientës së energjisë.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE REZULTATET

Strategjia e Strehimit Social përfshin objektivat strategjike si më mëposhtë:

1. Zhvillimi i kapaciteteve të 61 njësiteve vendore për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike;
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e qasjes në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara;
3. Bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e procesit të shpërndarjes së strehimit në 61 njësitë vendore;
4. Sigurimi i marreveshjeve të Partneritetit Publik-Privat (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social dhe rritjen e numrit të familjeve përfituese me 20%;
5. Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 30%;

Më poshtë paraqitet një përshkrim i objektivave të ndara sipas prioriteteve strategjike dhe rezultateve të pritshme për secilin objektiv.

3.1 Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave rreth strehimit social

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve të 61 njësiteve vendore për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike.

Për plotësimin e nevojave reale për strehim të popullatës së synuar dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në veçanti, si p.sh. komunitetet romë dhe egjiptiane, jetimët, personat me aftësi të kufizuara, gratë që janë viktime të dhunës në familje, etj., është e domosdoshme kuptimi dhe sigurimi i njohurive për kërkesën dhe ofertën për strehim në mënyrë periodike në të gjitha njësitë vendore. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet nënobjektivave të mëposhtëm:

Nënobjektivi 1.1. Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe në 61 njësitë vendore.

Nënobjektivi 1.2. Vlerësimi i nevojave për strehim në 61 njësi të qeverisjes vendore, duke u fokusuar në grupet në pozita të pafavorizuara.

Nënobjektivi 1.3. Krijimi i sitemit për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në 61 njësitë e vendit.

Nënobjektivi 1.4. Krijimi i një harte që synon prioritizimin e investimeve për komunitetin Rom dhe dhënia e asistencës për lehtësimin në strehim.

Nënobjektivi 1.5. Krijimi dhe zbatimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve në 61 njësi vendore mbi përdorimin e sistemit elektronik.

Çështjet që trajtohet nga objektivi 1:

- Mungesa e të dhënave ose ekzistenca e të dhënave të varfra rreth nevojave për strehim të grupeve në pozita të pafavorizuara në nivel vendor; kapacitete të dobta vendore në sektorin e strehimit social.

Rezultatet e pritshme

- Nevojat për strehim të popullsisë në Shqipëri janë kuptuar plotësisht.
- Boshllëqet në të dhëna lidhur me nevojat për strehim të grupeve në pozita të pafavorizuara janë mbyllur.
- Sistemi i mbledhjes së të dhënave është zgjeruar dhe përmirësuar.
- Është krijuar dhe zbatuar një plan për ngritjen e kapaciteteve vendore.

3.2 Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve të pafavorizuara përmes rishikimit të kuadrit ligjor, institucional dhe rregullator

Objektivi 2: Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e qasjes në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara.

Propozimet e politikave lidhur me strukturën institucionale për strehimin social nisin nga kushti se ndërsa duhen marrë në konsideratë kapacitetet dhe mundësitë e institucioneve ekzistuese dhe se nuk duhen krijuar institucione të reja nëse nuk është absolutisht e nevojshme, diskutimi i masave institucionale dhe i kuadrit ligjor duhet të nisë nga vlerësimi i elementeve që nevojiten për ta bërë funksionale politikën e strehimit social, në mënyrë specifike në drejtim të trajtimit të nevojave të grupeve në pozita të pafavorizuara, si romët, egjiptianët, jetimët, personat me aftësi të kufizuara etj. Çështja kryesore problematike që duhet të trajtohet përmes këtij veprimi është përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional që duhet vendosur për trajtimin efikas të nevojave për strehim të grupeve në pozita të pafavorizuara. Rekomandohet që, me t'u kryer studimet e nevojshme të realizueshmërisë dhe pas fitimit të përvojës në nivel vendor sa i takon zbatimin të programeve të

strehimit social, Qeveria e Shqipërisë të mendojë krijimin e shoqatave të strehimit social për administrimin e operacioneve të strehimit social.

Nënobjektivi 2.1. Ndryshime të ligjit të strehimit.

Nënobjektivi 2.2. Ngritja e kapaciteteve të 61 NJQV-ve në zbatimin e strategjisë së strehimit social.

Çështjet që trajtohet nga objektivi 2:

- Legjislacioni i paqartë për trajtimin e nevojave të grupeve në pozita të pafavorizuara
- Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004 në disa raste është i vakët, i paqartë (p.sh., procedurat e shpërndarjes duhet të jenë më transparente, nuk zbatohen sanksione, shpërndarja e fondeve është e paqartë, standardet për administrimin e banesave sociale me qira nuk janë të qarta).
- Problemet e të gjitha programeve të strehimit lidhur me qartësinë e mënyrës së tyre të funksionimit
- Problematika që rrjedhin nga ecuria e procesit të legalizimeve, zbatimi i vendimeve të AKKP-së, zbatimi i vendimeve gjyqësore për restituimin e pronës, apo edhe nga zbatimi i Aktit normativ nr. 3, të vitit 2012, të Këshillit të Ministrave.

Rezultatet e pritshme

- Kuadri ligjor dhe institucional për strehimin social është përmirësuar.
- Profilët e përfituesve janë përcaktuar qartë dhe janë bërë parashikime që trajtojnë diskriminimin pozitiv.
- Rolet e institucioneve të ndryshme janë përkrahur dhe kuptuar qartë.
- Kapacitetet drejtuese për të bashkërenduar operacionet e strehimit social në nivel të pushtetit qendror dhe vendor janë përmirësuar.
- Kompetencat e NJQV-ve, shoqëruar bashkë me mjetet financiare të nevojshme, janë rritur.
- Mënyra e shpërndarjes së fondeve për njësitë e qeverisjes vendore është rishikuar dhe komunikuar.
- Ecuria e NJQV-ve në zbatimin e programeve të strehimit social është rritur dhe përmirësuar.

Objektivi 3. Bashkërendimi midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e procesit të shpërndarjes së strehimit në 61 njësitë vendore.

Nënobjektivi 3.1. Bashkërendimi me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), organizatat e shoqërisë civile, dhe njësitë vendore për procedurat e shpërndarjes së banesave sociale tek përfituesit.

Nënobjektivi 3.2. Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim në programet e strehimit social, me fokus të veçantë grupet në pozita të pafavorizuara në 61 njësitë vendore.

Plani i veprimit për këtë objektivi fokusohet në sistemin që duhet përdorur për të përmirësuar punën e institucioneve të përfshira në ofrimin e strehimit social. Kjo punë udhëhiqet nga parimet e llogaridhënies dhe transparencës. Ky objektivi mbështetet nga arritja e objektivit të parë për sa i përket përcaktimit të qartë të rolit që ka secili institucion në procedurat e shpërndarjes, në kombinim me kapacitetet që ka secili institucion për zbatimin e rolit të tij. Gjithashtu, për të garantuar llogaridhënie dhe transparencë, informacioni lidhur me procedurat e shpërndarjes duhet të jetë i qartë dhe i arritshëm për të gjithë.

Çështjet që trajtohet nga objektivi 3:

- Mungesa e përvojës në ofrimin e strehimit social
- Mungesa e një plani bashkiak për strehimin

- Mungesa e të dhënave në nivel kombëtar lidhur me numrin e familjeve që kanë nevojë për strehim social
- Përqindja e ulët e kërkesave të bëra të suksesshme
- Përqindja e ulët e kërkesave të bëra në lidhje me kërkesën ekzistuese
- Mungesa e besimit tek autoritetet vendore
- Mospërmbushja e kritereve të përzgjedhjes nga më të varfrit
- Mungesa e financimeve të ofruara nga qeveria qendrore për NJQV-të
- Kapaciteti i dobët financiar i NJQV-ve
- Mungesa e të dhënave nga disa NJQV
- Legjislacioni i paqartë për trajtimin e nevojave të grupeve në pozita të pafavorizuara dhe të të varfërve
- Ligji nr. 9232, datë 13.5.2004 në disa raste është i ngatërruar, i paqartë (p.sh., procedurat e shpërndarjes duhet të jenë më transparente, nuk zbatohen sanksione, shpërndarja e fondeve është e paqartë, disa grupe në pozita të pafavorizuara nuk janë përfshirë etj.).
- Mungesa e informacionit në lidhje me programet sociale të strehimit
- Problemet e të gjitha programeve të strehimit lidhur me qartësinë e mënyrës së tyre të funksionimit

Rezultatet e pritshme

- Roli i MMSR-së, OSHC-ve dhe OJQ-ve për shpërndarjen e programeve të strehimit social për grupet në pozita të pafavorizuara është përcaktuar qartë dhe është bërë funksional.
- Përgjegjësitë e institucioneve për ndërthurjen e programeve të strehimit me programe të tjera sociale, të cilat fokusohen në arsim, shëndetësi, punësim, mbrojtje sociale, apo programe të tjera që synojnë fuqizimin e familjeve në pozita të pafavorizuara, janë përcaktuar qartë.
- Udhëzimet për procedurat e shpërndarjes së strehimit social janë përcaktuar qartë.
- Procedurat e shpërndarjes të programeve të strehimit për grupet në pozita të pafavorizuara janë përmirësuar.
- Shpërndarja e programeve të strehimit social tek grupet në pozita të pafavorizuara është rritur.
- Roli zbatues i procedurave të shpërndarjes së strehimit social nga NJQV-të është përcaktuar qartë dhe është bërë funksional.

Objektivi 4: Sigurimi i marreveshjeve të Partneritetit Publik-Privat (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social dhe rritjen e numrit të familjeve përfituese me 20%.

Nënobjektivi 4.1. Realizimi i marreveshjeve të PPP për ndërtimin e banesave sociale.

Nënobjektivi 4.2. Zbatimi i masave të nevojshme për të nxitur përdorimin e ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve në 61 njësitë vendore.

Çështjet që trajtohet nga objektivi 4:

- Mungesa e përvojës në ofrimin e strehimit social
- Mungesa e një plani bashkiak për strehimin
- Mungesa e financimeve të ofruara nga qeveria qendrore për NJQV-të
- Kapaciteti i dobët financiar i NJQV-ve
- Legjislacioni i paqartë për trajtimin e nevojave të grupeve në pozita të pafavorizuara dhe të të varfërve
- Çështjet e administrimit të tokës
- Mungesa e të dhënave (ose të dhëna me cilësi të ulët)

Rezultatet e pritshme

- Kuadri rregullator për ofrimin e strehimit është vlerësuar dhe përmirësuar.
- Palët e interesit që kanë detyrën e ofrimit të strehimit social janë mobilizuar dhe angazhuar.
- Modelet e partneritetit për ofrimin e strehimit social, me miratimin e palëve përkatëse të interesit, janë vlerësuar, aprovuar, dhe përfshirë në kuadrin rregullator.
- Instrumentet për përdorimin e ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve janë miratuar dhe zbatuar.
- Stimujt për anën e ofertës janë vënë në zbatim dhe janë përdorur.
- Modelet e pjesëmarrjes për ofrimin e strehimit grupeve në pozitive të pafavorizuara si edhe nga grupet në pozita të pafavorizuara janë vlerësuar, miratuar dhe përfshirë në kuadrin rregullator të programeve të strehimit social.
- Stimujt për anën e kërkesës janë vënë në zbatim dhe janë përdorur.

3.4 Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet zgjerimit dhe riorientimit të programe të strehimit social

Objektivi 5: Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 30%.

Nënobjektivi 5.1. Zhvillimi i programeve të ndryshme për strehimin e grupeve në pozita të pafavorizuara në 61 njësitë vendore.

Nënobjektivi 5.2 Zhvillimi i subvencioneve të ndryshme dhe grande-ve të menjëhershme për strehimin e grupeve me të ardhura të mesme dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në 61 njësitë vendore.

Çështjet që trajtohen nga objektivi 5:

- Niveli i lartë i kërkesës për programet e strehimit social / Numri i lartë i aplikantëve në listat pritëse
- Raporti i ulët i përfituesve në pozita të pafavorizuara
- Kushtet e vështira të banimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian
- Nevoja për rritjen e efikasitetit të energjisë në banesa

Rezultatet e pritshme

- Ulja e numrit të familjeve romë që jetojnë në kushte të papërshtatshme banimi.
- Rritja e stokut të banesave me efikasitet në përdorimin e energjisë.
- Ulja e numrit të familjeve në prag të përjashtimit social nëpërmjet subvencionimit/ bonusit të qirave.
- Shlyerja e detyrimeve ndaj bankës për subvencionimin e kredive të lehtësuara për 3894 familje që kanë përfituar kredine e lehtësuara.

Autoriteti për zbatimin e strategjisë

Ministria e Zhvillimit Urban do të drejtojë përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë, pasi bazuar në ligj ka autoritetin për të garantuar politika nxitëse dhe planifikon buxhetin për zhvillimin e strehimit social. Zbatimi i strategjisë për strehimin social duhet kryer me një gamë të gjerë aktorësh, nga të cilët qeverisja vendore në Shqipëri konsiderohet si aktori kryesor meqenëse kompetencat e zbatimit të strategjisë i janë deleguar qeverisjes vendore nëpërmjet decentralizimit të strukturave të qeverisjes qendrore.

MZHU-ja ka për detyrë të garantojë dhënien e mbështetjes politike për zbatimin e Strategjisë për Strehimin Social. Për të arritur në plane zbatimi reale është thelbësore që MZHU-ja të ketë njohje të vazhdueshme të kërkesës aktuale dhe të ardhshme për strehim social në Shqipëri.

Gjithashtu MZHU-ja duhet të garantojë se ekzistojnë ose që do të ngrihen kapacitetet për të zbatuar dhe monitoruar strategjinë, duke caktuar burime të mjaftueshme dhe duke zhvilluar një sistem mbështetës për ngritjen e kapaciteteve sipas nevojës (Plani i zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit).

Përveç kësaj, MZHU-ja duhet të informojë të gjithë aktorët për procesin e strategjisë për strehimin social.

IV. BURIMET FINANCIARE, ALOKIMI I BUXHETEVE DHE MENAXHIMI I RISKUT.

4.1 Burimet Financiare dhe Alokimi i Buxheteve.

Kosto e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e masave administrative të kësaj strategjie për vitet 2016-2025 dhe të planit të veprimit është rreth 7.3 mld lekë. Këto kosto përfaqësojnë 5.7 mld lekë ose financim nga buxheti i shtetit për projekte dhe subvencione për programet e strehimit të përfshira në planin e veprimit. Ky financim mbulon rreth 78% të kostos së përlogaritur për këtë strategji nga burimet e përcaktuara për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Ne menyrë të detajuar kostot për strategjinë paraqiten si më poshtë:

(a) Për periudhën 2016-2018

➤ Kosto totale	1,587 mln lekë
➤ Hendeku	59.850 mln leke
➤ Financimi i donatoreve UNDP	27.660 mln leke
➤ Buxheti i shtetit	1,500 mln leke

Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në masën 1,500 mln lekë, është e përlogaritur bazuar në kuotat tavan të planifikuara në projekt buxhetin afatmesëm 2016-2018 si dhe në përputhje me SKZHI.

(b) Për periudhën 2019-2025

➤ Kosto totale	5,672 mln leke
➤ Hendeku	1,508 mln leke
➤ Financimi i donatoreve UNDP	4.450 mln leke
➤ Buxheti i shtetit	4,160 mln leke

Nevojat për fonde për periudhën 2019-2025 në masën 4,160 mln lekë nga buxheti i shtetit, janë përlogaritur duke mbajtur një nivel të njëjtë me financimet në vitin 2018, për çdo vit buxhetor deri në 2025. Megjithatë periudha 2019-2025 i referohet një periudhe përtej projekt buxheteve afatmesme dhe përlogaritja është e vështirë të jetë e saktë, në parashikimin e financimeve kemi marrë për bazë vitin e fundit të projekt buxhetit afatmesëm 2016-2018.

Kostot që kërkohen nga donatorët dhe nepermjet Partneritetit Publik Privat janë llogaritur në masën 1.6 mld lekë ose 22.0% të kostos totale të strategjisë. Këto kosto përfaqësojnë financim nga UNDP në masën 32 mln lekë ose 2.0% të kostove të kërkuara nga donatorët. Pjesa tjetër përfshin hendekun financiar në masën 1,568 mln lekë ose 98.0% të financimeve të parashikuara për


donatorët. Ky hendek financiar është menduar të plotësohet nga donatorë të tjerë, nga të cilët jemi në pritje të një përgjigjeje dhe nëpërmjet Partneritetit Publik Privat.

Kostimi i Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte dhe ato jashtë projekteve. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në Republikën e Shqipërisë sikurse parashihet në ligjin organik të buxhetit të shtetit dhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave (MF).

Kostimi dhe buxheti i planit të veprimit të kësaj strategjie është mbështetur në elementet si më poshtë vijon:

- Kostot për zbatimin e strategjisë konsiderojnë jo vetëm shpenzimet kapitale por edhe ato korente të cilat, do ti shërbejnë subvencioneve të qirave sociale, granteve të menjëhershme dhe interesit të kredive të lehtësuara.
- Kostot e financuara nga donatorët janë konsideruar si shpenzime kapitale (trajtime dhe asistencë teknike, raporte vlerësimi etj.) në përputhje me udhëzimet përkatëse të MF.

Grafiku 1: Përbërja specifikë sipas burimeve të financimit



Kostot totale e strategjisë 2016-2025

Burimi	Buxheti	Përqindja
Buxheti i shtetit	5,660,751,624	78.00
Donatorët PNUD	32,110,000	0.40
Hendeku financiar	1,567,850,000	21.60
Totali	7,260,711,624	100

Tab. 4.1: Buxheti i nevojshëm

Politikat sektoriale	Buxheti i nevojshëm /Lekë	Buxheti Shtetit planifikuar /Lekë	Donatorë/ Lekë	Hendeku financiar/Lekë
Objektivat	a	2016-2025 b	2016-2025 c	d= a-(b+c)
TOTALI	7,260,711,624	5,660,751,624	32,110,000	1,567,850,000
Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve te 61 njesive vendore per sigurimin e njohurive rreth kerkeses dhe ofertes per strehim social ne menyre periodike.	79,540,000	0	27,090,000	52,450,000
Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe ne 61 njesite vendore.	2,440,000	0	2,440,000 UNDP	0
Vlerësimi i nevojave për strehim në 61 njesi te qeverisjes vendore, duke u fokusuar në grupet në pozita të pafavorizuara.	4,200,000	0	4,200,000 UNDP	0
Krijimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve per strehim ne 61 njesite e vendit.	52,450,000	0	0	52,450,000
Krijimi i një harte që synon prioritizimin e investimeve për komunitetin Rom.	16,000,000	0	16,000,000 UNDP	0
Krijimi dhe zbatimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve ne 61 njesi vendore.	4,450,000	0	4,450,000 UNDP	0
Objektivi 2: Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional per rritjen e qasjes ne strehim te 50% te familjeve ne pozita te pafavorizuara.	7,420,000	0	5,020,000	2,400,000

Ndryshime të ligjit të strehimit	6,320,000	0	5,020,000 UNDP	1,300,000
Ngritja e kapaciteteve te 61 NJQV-ve në zbatimin e strategjisë së strehimit social	1,100,000	0	0	1,100,000
Objektivi 3: Bashkëndimi i perpjekjeve midis institucioneve ne nivel qendror dhe vendor per permiresimin e procesit te shperndarjes se strehimit ne 61 njesite vendore.	5,800,000	0	0	5,800,000
Bashkëndimi me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), organizatat e shoqërisë civile, dhe njësive vendore për procedurat e shpërndarjes së banesave sociale tek përfituesit	300,000	0	0	300,000
Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni dhe aplikimi për përfituesit e mundshëm të programeve të strehimit social, me fokus të veçantë grupet në pozita të pafavorizuara, ne 61 njesi vendore.	5,500,000	0	0	5,500,000
Objektivi 4: Sigurimi i marreveshjeve te Partneritetit Publik-Privat (PPP) per permiresimin e alternativave te strehimit social si dhe rritjen e familjeve perfituese me 20%.	1,507,200,000	0	0	1,507,200,000
Realizimi i marreveshjeve te PPP per ndertimin e banesave sociale.	1,502,700,000	0	0	1,502,700,000 PPP
Zbatimi i masave të nevojshme për të nxitur përdorimin e	4,500,000	0	0	4,500,000

ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve ne 61 njesite vendore.				
Objektivi 5: Zgjerimi i alternativave te strehimit permes programeve te orientuara per familjet me te ardhura te uleta e te mesme dhe kryesisht ato te pavaforizuara me 30%.	5,660,751,624	5,660,751,624	0	0
Zhvillimi i programeve të ndryshme për strehimin e grupeve në pozita të pafavorizuara ne 61 njesite vendore.	2,176,434,000	2,176,434,000	0	
Zhvillimi i subvencione të ndryshme dhe grandeve për strehimin e grupeve të mesme dhe grupeve në pozita të pafavorizuara ne 61 njesite vendore.	3,484,317,624	3,484,317,624	0	0

4.2 Menaxhimi i Riskut.

Zbatimi me sukses i Strategjisë së Strehimit Social mund të vihet në vështirësi si pajosë e ekzistencës së disa risqeve, të cilat nëse nuk analizohen sic duhet dhe nëse nuk gjendet përqsja e duhur për ti adresuar, mund të sjellin vështirësi reale në suksesin e saj.

Risqet kryesore të cilat mund të kenë efekt në zbatimin me sukses të strategjisë kanë lidhje me Qeverine Qendrore dhe një pjese e tyre kanë lidhje direkt me Njësitet Vendore.

Risqet në nivel Qendror:

1. Angazhimi i të gjitha strukturave të përfshira në këtë Strategji;
2. Rregullimi i kuadrit ligjor në lidhje me Partneritetin Publik-Privat;
3. Mbështetja e kësaj strategjie me fondet e nevojshme për të siguruar suksesin e saj.

Risqet në nivel lokal:

1. Angazhimi i njësive vendore për të zbatuar aktivitetet pjesë e kësaj strategjie;
2. Angazhimi i njësive vendore për të përgatitur plane veprimi 10 vjecare;
3. Njësitet vendore angazhohen të kontribuojnë me buxhetin e tyre në çështje të strehimit social.

Analiza e Risqeve dhe Adresimi i tyre:

Risqet në nivel Qendror:

1. Angazhimi i të gjitha strukturave të përfshira në këtë Strategji.

Zbatimi i suksesshëm i planit të veprimit të kësaj strategjie, për të mundësuar dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të vendosura, kërkon dhe përfshirjen e shumë strukturave të tjera, pjesë e qeverise qendrore. Angazhimi i këtyre strukturave në çështje që kanë të bëjnë me strehimin social mund të konsiderohet si faktor i rëndësishëm në suksesin e kësaj strategjie.

Ministri të tilla si Ministria e Financës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Çështjeve Sociale dhe Rinisë, kanë lidhje direkte me një pjesë të mirë të aktiviteteve të planifikuara në këtë strategji. Mos anagazhimi i tyre dhe mos koordinimi i mirë i informacioneve dhe burimeve, përbën një risk të lartë për suksesin e saj.

Për të shmangur këtë rrezik është menduar dhe vënë në zbatim, përfshirja e këtyre strukturave në të gjithë procesin e hartimit të kësaj strategjie, si dhe në aktivitetet për zbatimin e saj. Përfaqësues të Ministrive të sipërpërmendura kanë qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e strategjisë, por gjithashtu dhe për rishikimin e saj. Struktura të vecanta të këtyre institucioneve janë përfshirë dhe në planin e zbatimit.

2. Rregullimi i kuadrit ligjor në lidhje me Partneritetin Publik-Privat.

Partneriteti Publik-Privat konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për adresimin e nevojave për strehimin social. Mungesa e përfshirjes së biznesit në zgjidhjet e mundshme për strehimin social, si dhe kuadri ekzistues ligjor janë konsideruar si pengesa të mundshme në përfitimet e mundshme nga përdorimi i këtij instrumenti si zgjidhje për ofrimin e strehimit social për shtresat në nevoje, dhe jo vetëm.

Mos funksionimi i këtij instrumenti si një zgjidhje, konsiderohet si një risk i nivelit të mesëm, sepse mund të rrezikojë adresimin e një pjese të konsiderueshme të përfituesve të parashikuar.

Për të mundësuar adresimin e këtij risku, është menduar që si pjesë e planit të zbatimit të kësaj strategjie do adresohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me përshtatjen e kuadrit ligjor, për të nxitur zbatimin e këtij instrumenti si zgjidhje.

Njëkohësisht është menduar dhe angazhimi i drejtuesve të njesive vendore, për të ofruar lehtësirat e nevojshme për të mundësuar këtë bashkëpunim. Kjo do arrihet nëpërmjet aktiviteteve për ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të njesive vendore.

3. Mbështetja e kësaj strategjie me fondet e nevojshme për të siguruar suksesin e saj.

Sic është evidentuar dhe nga analiza financiare që i është bërë planit të veprimit, shikohet që fondet e nevojshme për zbatimin me sukses të aktiviteteve të planifikuara janë shumë më tepër se sa mundësitë aktuale financiare. Ky fakt përbën një rrezik real për suksesin e strategjisë.

Në këtë aspekt kërkohet jo vetëm angazhimi i Qeverisë për alokimin e fondeve të nevojshme, por njëkohësisht dhe sigurimi i mbështetjes nga partnerë të tjerë.

Për të mundësuar pasjen e një buxheti dhe mundësi financimi sa më reale, gjatë procesit të buxhetimit të strategjisë, u përfshinë përfaqësues të këtyre institucioneve dhe partnereve të mundshëm.

Risqet në nivel lokal:

1. Angazhimi i njesive vendore për të zbatuar aktivitetet pjesë e kësaj strategjie.

Reforma e re territoriale vec efekteve të tjera, ka afektuar gjithashtu dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me strehimin social. Kështu në pjesën më të madhe të bashkive të reja, mungon informacioni në lidhje me nevojat reale për strehim social. Vec kësaj nga studimet e bëra, rezulton që një pjesë e mirë e bashkive, sidomos bashkitë e vogla, nuk kanë staf të dedikuar për çështjet e strehimit social, madje nuk e kanë fare si sektor. Kjo bën që strehimi social të mos konsiderohet ndër prioritetet për to.

Ky fakt përbën një risk të konsiderueshëm për zbatimin me sukses të strategjisë, sepse angazhimi i njësive vendore mundëson:

- Informacion në lidhje me nevojat;
- Informacion në lidhje me historikun;
- Informacion në lidhje me burimet;
- Informacion në lidhje me mundësitë;
- Përfshirjen e Njësive Vendore në adresimin e çështjeve të strehimit social.

Të dhënat e mësipërme janë pjesë shumë e rëndësishme e ndërtimit të programeve të strehimit në nivel kombëtar. Për të adresuar këtë problem është menduar:

- Njesimi i formateve për mbledhjen e informacionit;
- Ngritja e kapaciteteve për punonjësit e njësive vendore;
- Ndërtimi i një sistemi on-line për mbledhjen e të dhënave;
- Përditësimi periodik i këtyre të dhënave;
- Ndërtimi i një sistemi on-line aplikimi.

2. Angazhimi i njësive vendore për të përgatitur plane veprimi 10 vjecare.

Gjatë procesit të vleresimit për hartimin e strategjisë, është evidentuar që një pjesë shumë e madhe e njësive vendore nuk kanë fare plane veprimi për të adresuar nevojat e strehimit social.

Problematika që sjell ky fakt përbën një risk relativisht të konsiderueshëm për zbatimin e strategjisë, sepse:

- Nuk mundësohet analiza e situatës aktuale;
- Nuk ka informacion për nevojat reale;
- Nuk ka informacion për kostot e nevojshme për adresimin e këtyre nevojave.

Ngritja e kapacitetit të stafit të njësive vendore dhe ofrimi i ekspertizës për hartimin e këtyre planeve, është menduar si përqsja e nevojshme për adresimin me sukses të këtij problemi.

3. Njësive vendore angazhohen të kontribuojnë me buxhetin e tyre në çështje të strehimit social.

Çështjet e fondeve dhe shpërndarja e tyre sipas prioriteteve të njësive vendore konsiderohet si një tjetër rrezik potencial për zbatimin me sukses të kësaj strategjie.

Aktualisht, vetëm një numër shumë i limituar i njësive vendore kanë alokuar pjesë të buxhetit të tyre për të adresuar çështje që kanë të bëjnë me strehimin social. Për njësi të tjera, fondet nga Qeveria

qëndrore nëpërmjet programeve të strehimit social janë konsideruar si burimi i vetëm për të adresuar këto nevoja.

Një pjesë tjetër e njësive vendore nuk kanë alokuar fonde sepse nuk kanë patur informacion për këto nevoja.

Përgatitja e planeve 10 vjecare në nivel lokal është menduar si hapi i parë në këtë drejtim. Pas kësaj, si tjetër element i rëndësishëm është konsideruar dhe rritja e ndërgjegjësimit të drejtuesve të njësive vendore për të vendosur strehimin social si prioritet të tyre.

Objektivi /Nënobjektivi	Aktivitetet	Afati	Rezultatet & Treguesit	Rreziku	Niveli i Rrezikut	Efekti	Përqasja
1. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË 61 NJËSIVE VENDORE PËR SIGURIMIN E NJOHURIVE RRETH KËRKESËS DHE OFERTËS PËR STREHIM SOCIAL NË MËNYRË PERIODIKE.							
1.1 Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe ne 61 njesite vendore.	1.1.1 Identifikimi i problematikave të hasura pranë njësive vendore në lidhje me programin e kreditimit të lehtësuar.	2015-2016	1 raport vlerësimi.	1. Mungesa e angazhimit të njësive vendore në lidhje me grumbullimin e të dhënave të nevojshme. 2. Mungesa e ekspertizës në analizimin e të dhënave dhe vlerësimin e tyre.	I lartë	1. Nuk mundësohet pasja e një analize të plotë në nivel vendor. 2. Informacioni nga njësitë e reja nuk sigurohet.	1. Ngritja e një sistemi të unifikuar për mbledhjen e të dhënave. 2. Ngritja e kapaciteteve të stafit të njësive vendore në lidhje me këtë proces.
	1.1.2 Evidentimi dhe vlerësimi i nevojave reale për strehim sipas programeve të strehimit.	2016	1 raport vlerësimi.				
	1.1.3 Unifikimi i procedurave të përdorura për programin e kreditimit të lehtësuar.	2016	1 procedurë e unifikuar dhe e miratuar nga MZHU për 61 NjQV				
	1.1.4 Vlerësimi i nevojave financiare sipas programeve të strehimit.	2016	1 raport vlerësimi.				
1.2 Vlerësimi i nevojave për strehim në 61 njesite vendore, duke u fokusuar në grupet në pozita të pafavorizuara	1.2.1 Shqyrtimi i situatës ekzistuese të strehimit të grupeve në pozita të pafavorizuara dhe i grupeve me të ardhura të ulta dhe të mesme	2017	1 raport vlerësimi.	1. Mungesa e angazhimit të njësive vendore në lidhje me grumbullimin e të dhënave të nevojshme.	I lartë	1. Nuk mundësohet pasja e një analize të plotë në nivel vendor.	1. Ngritja e një sistemi të unifikuar për mbledhjen e të dhënave. 2. Ngritja e kapaciteteve të

	1.2.2 Vlerësimi i kërkesës dhe ofertës së strehimit social. Percaktimi i mundësive për të perballuar kostot për grupet në pozita të pafavorizuara dhe grupet me të ardhura të ulëta dhe të mesme	2017	1 analizë/raport për cdo NjQV dhe një analizë/raport në nivel kombëtar	2. Mungesa e ekspertizës në analizimin e të dhënave dhe vlerësimin e tyre. 3. Mungesa e burimeve për të adresuar nevojat për strehim social.		2. Informacioni nga njësitë e reja nuk sigurohet. 3. Nuk mundësohet informacion në lidhje me burimet aktuale të vetë njësive vendore.	stafit të njësive vendore në lidhje me këtë proces. 3. Mbështetja financiare për të adresuar realizimin me sukses të këtij objekti.
	1.2.3 Evidentimi i burimeve ekzistuese të strehimit dhe hartimi i raportit të vlerësimit të nevojave për strehim.	2017	1 raport vlerësues				
1.3 Krijimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në 61 njesite e vendit.	1.3.1 Krijimi i nje një sistemi për mbledhjen e të dhënave lidhur me nevojat për strehim në nivel vendor, në bashkepunim me INSTAT	2016-2018	1 program kompjuterik databaze	1. Sigurimi i fondeve të nevojshme për ndërtimin e sistemit elektronik për aplikimin online. 2. Ngritja e kapaciteteve të stafit të njësive vendore për përdorimin dhe analizën e të dhënave. 3. Mundësia dhe njohuritë e qytetarëve për të aplikuar online.	I mesëm	1. Në mungesë të sistemit kërkohet më shumë angazhim fizik për mbledhjen dhe analizën e të dhënave. 2. Më pak mundësi për qytetarët për të patur informacion në lidhje me programet.	1. Gjetja e donatorëve për financimin e kësaj inisiativë. 2. Trainimi i stafit të njësive vendore dhe stafit të ministrisë përgjegjëse. 3. Komunikimi i inisiativës për publikun e gjerë.
	1.3.2 Krijimi i një sistemi elektronik për aplikim online për strehim social të qytetarëve dhe monitorohet në sistem nga MZHU	2017-2018	1 sistem elektronik për aplikimet në programet e strehimit				
	1.3.3 Testimi në formë pilot i sistemit elektronik të mbledhjes së të dhënave	2017-2018	Sistemi i ndërtuar për mbledhjen e të dhënave				
	1.3.4 Hartimi i manualit për mënyrën e funksionimit të sistemit elektronik	2019	1 manual përdorimi				
	1.3.5 Vënia në zbatim e sistemit të mbledhjes së të dhënave	2020	Sistemi i instaluar në cdo NjQV-monitoruar nga MZHU				

1.4 Krijimi i një harte që synon prioritizimin e investimeve për komunitetin Rom dhe dhenia e asistencës për lehtësimin në strehim.	1.4.1 Identifikimi i zonave ku jetojnë komunitetet romë dhe egjiptiane	2016	1 raport vlerësues mbi situatën e Romëve dhe Egjiptianëve në 61 bashki	1. Saktësia e informacionit të mbledhur. 2. Niveli i angazhimit të njëjësive vendore në këtë proces. 3. Mundësia e financimit të programeve nga ana e Qeverisë. 4. Niveli i angazhimit të partnerëve në këtë proces.	I mesëm	1. Ulje e mundësi për përfshirje të këtyre grupeve në programet e strehimit social. 2. Moshnjohje e nevojave reale të këtyre grupeve.	1. Gjetja e donatorëve për financimin e kësaj inisiativë. 2. Trainimi i stafit të njëjësive vendore dhe stafit të ministrisë përgjegjëse.
	1.4.2 Vlerësimi i situatës së vendbanimeve të tyre dhe lidhja me rrjetin e infrastrukturës (banesa, ujësjellës, kanalizime, rrugë, ndriçim, etj.)	2016	1 raport dhe krijimi i një databaze me të dhënat				
	1.4.3 Përgatitja e një harte me zonat e identifikuar ku banojnë komuniteti rom/egjiptian.	2017	1 Hartë për komunitetin rom dhe egjiptian				
	1.4.4 Përcaktimi i nevojave financiare të Bashkive për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit Rom	2017	1 raport mbi nevojat financiare për cdo NjQV ku jetojnë komunitete romë dhe egjiptiane				
	1.4.5 Përgatitja e Plan Veprimit për masat që do të ndërmerren nga pushteti lokal, qëndror dhe aktorët e tjerë për përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre komuniteteve	2017-2018	1 Plan Veprimi dhe miratimi i tij nga këshillat bashkiake				
	1.4.6 Ofrimi i asistencës për legalizim për përmirësimin e vendbanimeve informale të romëve dhe egjiptianëve dhe/ose i objekteve që u përkasin këtyre grupeve	2018-2021	1 Udhëzim dhe manuali i miratuar.				

1.5 Krijimi dhe zbatimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve ne 61 njesite vendore mbi perdorimin e sistemit elektronik	1.5.1 Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim në nivel të NJQV-ve	2019-2020	1 Takim konsultativ me përfaqesues të 61 bashkive	1. Mungesa e stafit të dedikuar për probleme të strehimit në një pjesë të bashkive të reja. 2. Ruajtja e njohurive të marra.	I mesëm	1. Pasaktësi në të dhënat dhe ruajtjen e tyre në nivel vendor. 2. Ulje e cilesisë së shërbimit për qytetarët.	1. Angazhimi i drejtuesve të njësive vendore në përcaktimin e personave përgjegjës për ndjekjen e programeve të strehimit. 2. Angazhimi i drejtuesve të NJV për mbajtjen në punë të këtyre punonjësve të trajnuar.
	1.5.2 Pilotimi i sistemit elektronik ne dy bashki te vendit me karakteristika te ndryshme ne fushen e strehimit.	2019-2020	Perdorimi i sistemit elektronik ne dy bashki				
	1.5.3 Vënia në funksion e sistemit elektronik ne 61 bashkite e vendit.	2020	Numri i punonjesve te trajnuar ne 61 bashki. Raporti mbi trajnimet e ofruara.				
2. PËRMIRESIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR RRITJEN E QASJES NË STREHIM TË 50% TE FAMILJEVE NË POZITA TË PAFAVORIZUARA.							
2.1 Ndryshime të ligjit të strehimit	2.1.1 Identifikimi i roleve të mbivendosura dhe i roleve që mungojnë.	2016	1 raport vleresimi.	1. Niveli i angazhimit i të gjithë aktorëve pjesë e këtij procesi. 2. Gjetja e ekspertizës së nevojshme për të kryer këtë proces.	I ulët.	1. Mos adresimi i nevojave të shtresave me të ardhura të ulta. 2. Mos adresimi i çështjeve problematike në ligjin ekzistues.	1. Sigurimi i fondit të nevojshëm dhe ekspertëve.
	2.1.2 Organizimi i diskutimeve me grupe tematike me qëllim gjetjen e modeleve të bashkëpunimit ndërinstytucional në ofrimin efikas të strehimit social për grupet në pozita të pafavorizuara (si psh. romët, egjiptianët, jetimët, personat me aftësi të kufizuara etj.)	2016	1 Raport me gjetjet e propozuara nga ky takim.				

2.1.3 Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të institucioneve të ndryshme shtetërore të lidhura me sektorin e strehimit social, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor.	2016	Reflektimi në ligj i roleve të institucioneve për strehimin.				
2.1.4 Shqyrtimi i kuadrit ligjor ekzistues për të parë nëse janë apo jo të qarta profilet (përshkrimet) e përfituesve.	2016	Vlerësimi dhe reflektimi në ndryshimet e ligjit për strehimin.				
2.1.5 Hartimi i nje raporti me sugjerime konkrete per ndryshimet në ligj, duke përfshirë dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit për komunitetin rom duke e përfshirë në masën 5% në çdo program strehimi	2016	1 Raport dhe reflektimi në ndryshimet në ligj.				
2.1.6 Rishikimi dhe mundësitë e ndryshimit të kuadrit ligjor në lidhje me planifikimin dhe miratimin e fondeve nga njësitë e qeverisjes vendore.	2016	Reflektimi në ndryshimet në ligj.				
2.1.7 Rishikimi i ligjit për funksionimin e strukturave të strehimit në njësitë e qeverisjes vendore / Rishikimi i rolit dhe përgjegjësi të strukturës së strehimit social.	2016	1 raport vlerësimi dhe reflektimi në ndryshimet në ligj.				

<p>2.1.8 Përcaktimi i përgjegjësisë të insitucioneve për ndërthurjen e programeve të strehimit me programe të tjera sociale, të cilat fokusohen në arsim, shëndetësi, punësim, mbrojtje sociale, apo programe të tjera që synojnë fuqizimin e familjeve në pozita të pafavorizuara.</p>	<p>2016</p>	<p>Ligji i ndryshuar.</p>				
<p>2.1.9 Miratimi dhe përfshirja e modeleve të partneritetit në kuadrin ligjor/rregullator dhe/ose përshkrimin e programeve ekzistuese të strehimit social.</p>	<p>2016</p>	<p>Ndryshimet e ligjit për strehimin i modeleve të PPP.</p>				
<p>2.1.10 Hartimi i akteve nenligjore për procedurat e shpërndarjes së banesave sociale në nivel vendor përmes bashkëpunimit të qeverisë qendrore (MZHU), MMSR, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të NJQV-ve.</p>	<p>2016</p>	<p>Hartimi i akteve nënligjore sipas programeve.</p>				
<p>2.1.11 Rishikimi i legjislacionit për bashkëpunimin me institucionet që miratojnë projektet, kryejnë ndërtimin publik dhe shpronësimin, për të mundësuar strehimin e familjeve që nuk përfitojnë nga shpronësimet publike.</p>	<p>2016-2025</p>	<p>Hartimi i një akti ligjor për strehimin e 100% të familjeve të dëbuara me forcë sa herë paraqiten raste të tilla.</p>				
<p>2.1.12 Rishikimi i kuadrit ligjor për përshtatjen e objekteve të dala jashtë funksionit, me synim strehimi social sipas normave të strehimit.</p>	<p>2016</p>	<p>Miratimi i ndryshimeve ligjore.</p>				

	2.1.13 Miratimi i ndryshimeve të ligjit të strehimit.	2016	Miratimi i ndryshimeve ligjore.				
	2.1.14 Përcaktimi i standarteve minimale të strehimit referuar modeleve të BE-se.	2017	1 Akt nënligjor.				
2.2 Ngritja e kapaciteteve të 61 NJQV-ve në zbatimin e strategjisë së strehimit social.	2.2.1 Përcaktimi i kriterëve të kualifikimit për kërkimin dhe marrjen e fondeve nga pushteti qendror dhe/ose institucionet financiare për realizimin e operacioneve të strehimit në nivel vendor.	2016	Udhëzimi me kriteret e kualifikimit.	1. Mungesa e stafit të dedikuar për probleme të strehimit në një pjesë të bashkive të reja. 2. Ruajtja e njohurive të marra.	I mesëm	1. Pasaktësi në të dhënat dhe ruajtjen e tyre në nivel vendor. 2. Ulje e cilësisë së shërbimit për qytetarët.	1. Angazhimi i drejtuesve të njësive vendore në përcaktimin e personave përgjegjës për ndjekjen e programeve të strehimit. 2. Angazhimi i drejtuesve të NJV për mbajtjen në punë të këtyre punonjësve të trajnuar.
3. BASHKËRENDIMI MIDIS INSTITUCIONEVE NË NIVEL QËNDROR DHE VENDOR PËR PËRMIRËSIMIN E PROCESIT TË SHPËRNDARJES SË STREHIMIT NË 61 NJËSITË VENDORE.							
3.1 Bashkërendimi me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), organizatat e shoqërisë civile dhe njësive vendore për procedurat e shpërndarjes së banesave sociale tek përfituesit	3.1.1 Përshkrimi dhe vlerësimi i rolit bashkërendues të MMSR-së, organizatave përkatëse të shoqërisë civile, dhe NJQV-ve.	2016-2017	1 Raport vlerësimi.	1. Niveli i angazhimit i të gjithë aktorëve pjesë e këtij procesi.	I ulët.	1. Mungesa e sigurisë që familjet më në nevojë do përfitojnë. 2. Nxit mungesën e transparencës.	1. Përfshirja e këtyre aktorëve në të gjitha hapat pjesë e këtij procesi.

<p>3.2 Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim në programet e strehimit social, me fokus të veçantë grupet në pozita të pafavorizuara në 61 njesite vendore.</p>	<p>3.2.1 Prodhimi i materialeve informuese mbi mundësitë e përfitimit dhe aplikimit, dhe bashkëpunimi me NJQV dhe OQV për shpërndarjen e tyre me fokus të veçantë arritjen e grupet në pozita të pafavorizuara, si të verbërit dhe personat nuk dëgjojnë, komuniteti rom etj..</p>	<p>2017-2020</p>	<p>500 afishe, 3 orë transmetim në radio, 5 000 fletushka, 1 rubrikë mbi procedurat e shpërndarjes së strehimit në faqet shtetërore në internet.</p>	<p>1. Sigurimi i fondeve të nevojshme.</p>	<p>I mesëm</p>	<p>1. Nuk mundësohet komunikimi i këtij procesi.</p>	<p>1. Sigurimi i fondit të nevojshëm nga donatorë.</p>
<p>4. SIGURIMI I MARRËVESHJEVE TË PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT (PPP) PËR PËRMIRËSIMIN E ALTERNATIVAVE TË STREHIMIT SOCIAL SI DHE RRITJEN E FAMILJEVE PËRFITUESE ME 20%.</p>							
<p>4.1 Realizimi i marrëveshjeve të PPP për ndërtimin e banesave sociale.</p>	<p>4.1.1 Vlerësimi i modelit të PPP për ndërtimin e banesave sociale.</p>	<p>2016</p>	<p>1 Udhëzues për modelin e PPP.</p>	<p>1. Interesi i sipërmarrjeve private për tu angazhuar në një iniciativë të tillë. 2. Mundësia e zbatimit të këtyre iniciativave në të gjitha njesite vendore. 3. Mundësia reale e njesive vendore për të ofruar lehtësirat e nevojshme për këtë lloj partneriteti. 4. Interesi i qytetarëve për të tilla programe.</p>	<p>I lartë</p>	<p>1. 20% e familjeve në nevojë nuk do mund të përfitojnë nga ky program.</p>	<p>1. Angazhimi dhe bashkëpunimi i Qeverisë Qendrore, Njesive vendore dhe gjithë aktorëve të tjerë për të mundësuar zbatimin e këtij programi. 2. Rregullimi i kuadrit ligjor për të lehtësuar dhe orientuar këtë lloj partneriteti. 3. Sigurimi i transparencës për këtë proces.</p>
	<p>4.1.2 Hartimi i studim- projektimit për zonën ku do të synohet të realizohet PPP.</p>	<p>2016</p>	<p>1 Projekt final për zbatim.</p>				
	<p>4.1.3 Përgatitja e dokumentave tekniko ligjore për konkretizimin e procedurave të PPP/ konkension.</p>	<p>2018</p>	<p>1 dokument tekniko ligjor i miratuar nga komisioni.</p>				
	<p>4.1.4 Konkretizimi dhe ndjekja e zbatimit të marrëveshjes së PPP.</p>	<p>2016-2020</p>	<p>1 marrëveshje e miratuar dhe raporte 6 mujore mbi zbatimin e marrëveshjes.</p>				

4.2 Zbatimi i masave të nevojshme për të nxitur përdorimin e ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve në 61 njësite vendore.	4.2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i instrumenteve.	2018	1 raport vlerësimi i situatës aktuale pas identifikimit të instrumentave.				
	4.2.2 Zbatimi i instrumenteve nëpërmjet akt-marrëveshjeve.	2019-2020	Akt marrëveshjet e miratuara.				
5. ZGJERIMI I ALTERNATIVAVE TË STREHIMIT PËRMES PROGRAMEVE TË ORIENTUARA PËR FAMILJET MË TË ARDHURA TË ULTA E TË MESME DHE KRYESISHT ATO TË PAVAFORIZUARA ME 30%.							
5.1 Zhvillimi i programeve të ndryshme për strehimin e grupeve në pozita të pafavorizuara në 61 njësite vendore.	5.1.1 Grande të vogla për komunitetin Rom dhe Egjiptian me qëllim përmirësimi i kushteve të banimit.	2016-2025	Përmirësimi i kushteve të banimit të rreth 24% e familjeve romë deri në 2018 dhe rreth 76% deri në 2025.	1. Mundësia financiare. 2. Interesi i qytetarëve për programet e ofruara.	I lartë	1. Përfituesit e planifikuar për tu adresuar nga këto programe nuk sigurojnë strehim social. 2. Rrezikohet zbatimi i strategjisë.	1. Përfshirja e nevojave në Planet Buxhetore. 2. Formalizimi i mbështetjes nga donatorë të ndryshëm. 3. Menaxhimi shumë i mirë i fondeve në dispozicion. 4. Njësite vendore hartojnë plane 10 vjecare dhe pëfshijnë adresimin e nevojave për strehim social në buxhetet e tyre.
	5.1.2 Investime për projekte të efikasitetit të energjisë në banesa.	2016-2020	Përfitimi për kursimin e energjisë në banesa për rreth 19% e familjeve deri në 2018 dhe rreth 81% deri në 2025				

	5.1.3 Studim projektim për zhvillimin urban të zonave pronë shtetërore (fizibilitet, studim projektim).	2016	1 studim fizibiliteti dhe 1 projekt zbatimi					5. Transparencë maksimale e të gjithë proceseve.
	5.1.4 Rehabilitimi i godinave për trajtim me strehim të përshtatshëm të grupit të jetimëve.	2016	27 familje përfituese nga ky projekt.					6. Komunikim i vazhdueshëm mes të gjithë aktorëve.
	5.1.5 Bashkëfinancim për Projektin e Banesave Sociale me qira.	2016	Strehimi i 214 familjeve në banesa sociale me qira në Durrës					
5.2 Zhvillimi i Subvencioneve të ndryshme dhe grandeve të menjëhershme për strehimin e grupeve të mesme dhe në pozita të pafavorizuara në 61 njësitë vendore.	5.2.1 Subvencionimi i qerave për familjet e shpronësuara në Vlorë dhe Tiranë (rastet e forcë eviction).	2016-2017	Subvencionimi i qirave për 100% të familjeve të synuara					
	5.2.2 Subvencionimi i interesave të kredive të lehtësuara me BKT/Raiffeisen Bank.	2016-2025	Subvencionimi i 100% të familjeve që kanë përfituar kredi.					

5.2.3 Subvencionimi i qirasë për objektet në pronësi të bashkisë	2018-2025	Subvencioni I qirase per rreth 292 familje ose 13 % e synimit deri ne 2018 dhe rreth 87% deri ne 2025				
5.2.4 Subvencionimi i qirasë (Bonusi) për banesat në treg të lirë të kontraktuara nga njësitë vendore	2016-2025	Perfitimi I bonusit nga rreth 29% e familjeve te synuara deri 2018 dhe 71% familjeve deri ne 2025				
5.2.5 Grande te menjehershme per PAK dhe Jetim	2017-2025	Perfitimi I grandit nga rreth 18 % e familjeve PAK dhe Jetim deri ne 2018 dhe rreth 82% e familjeve deri ne 2025				

V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Strategjia e Strehimit Social do të jetë pjesë integrale e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), dhe mekanizmave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBAM), të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Monitorimi i strategjisë do të përfshijë analizimin e rregullt të burimeve, produkteve dhe rezultateve të ndërhyrjeve në politika. Ajo do të bazohet në një sistem të mbledhjes së informacionit dhe analizës së treguesve të monitorimit siç është paraqitur në Tabelën 5.3 të këtij Kreu, ku jepet një zbatim i rezultateve të pritura për secilin objektiv, treguesit që do të përdoren për të matur çdo rezultat, modaliteti i vlerësimit, afati kohor modalitetit të vlerësimit dhe institucionet përgjegjëse. Arritja e rezultateve të pritura që paraqiten në Tabelën 5.3 do të ndihmojë si përfundim përmbushjen e nevojave për strehim që kanë grupet me të ardhura të ulëta dhe të mesme dhe konkretisht grupet në pozita të pafavorizuara, në përputhje me gatishmërinë, arritshmërinë, përballueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e programeve dhe projekteve të strehimit. Strategjia do të monitorohet nga Komiteti Kombëtar i Strehimit i miratuar me vendim të Keshillit të Ministrave, që do të sigurojë përshtatjen e masave për arritjen e objektivave strategjike, duke marrë parasysh risqet e mundshme. Në këtë mënyrë do të rritet efikasiteti dhe efektiviteti i qeverisjes.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave strategjike të Strehimit Social (referuar në këtë strategji) do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- rekomandohen ndryshime në legjislacionin për strehimin në fuqi, programet e strehimit, duke pasur parasysh arritjet, mangesitë dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian, apo shoqërisë civile dhe Avokatit të popullit;
- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të nxitet bashkëpunimi me institucionet e tjera të përfshira edhe tërthorazi me strehimin social;

Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) do të ketë përgjegjësinë për të sistemuar informacionin e monitorimit për ta prezantuar në Qeveri.

5.1 Sistemi i informacionit dhe mbledhjes së të dhënave

Objektivat dhe rezultatet e Strategjisë së Strehimit Social do të gjejnë zbatim nëpërmjet Planit të Veprimit dhe dokumentet e tjera të planifikimit. Zbatimi i Planit të Veprimit do të monitorohet me anë të treguesve të performancës që masin rezultatet e çdo veprimtarie/mase dhe caktojnë përgjegjësitë për implementimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Një nga objektivat e Strategjisë së Strehimit Social fokusohet në ngritjen e një sistemi i cili do të shërbejë për grumbullimin e të dhënave rreth strehimit social në çdo njësi vendore. Kjo përfshin të dhëna rreth aplikantëve dhe përfituesve të programeve të strehimit social, rreth karakteristikave të grupeve të përjashtuara dhe nevojave të tyre për strehim social, si dhe rreth burimeve të njësive vendore të cilat mund të mobilizohen me qëllim ofrimin e strehimit. Ky informacion i cili do të grumbullohet në nivel vendor do të komunikohet Drejtorisë së Shërbimeve Urbane dhe Strehimit nga secila njësi vendore. Informacioni do të grumbullohet dhe më tej analizohet për të matur ndryshimin në kohë.

Kuadri i ri strategjik ka për qëllim të realizojë një proces të gjerë dhe efikas të monitorimit bazuar në një sistem të mirë-organizuar raportimi. Procesi i monitorimit do të fillojë në vitin 2016 dhe do të zbatohet nga strukturat e specifikuar në pikën 5.3 të këtij Kreu.

Monitorimi do të kryhet çdo vit dhe raportet e monitorimit dhe vlerësimit do të hartohen dhe miratohen në afate 1 vjeçare. Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit përcaktohet në pikën 2 të këtij Kreu.

5.2 Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit

Mënyra kryesore e raportimit do të jetë përgatitja e një raporti vjetor ku do të paraqiten rezultatet e analizës duke përfshirë arritjet dhe sfidat. Raporti do të përfshijë edhe profilet e njësive vendore të cilat kanë zbatuar modele të suksesshme të programeve të strehimit social me qëllim komunikimin e informacionit dhe transferimin e njohurive në të gjitha njësitë vendore. Raporti vjetor do të përgatitet nga Drejtoria e Sherbimeve Urbane dhe do të hartohet e miratohet brenda 3 mujorit të parë të vitit pasardhës së vitit të monitoruar. Ky raport do të:

- Vlerësojë strategjinë e strehimit social me fokus progresin e arritur në përmbushjen e masave dhe veprimtarive nga njëra anë dhe e treguesve të monitorimit nga ana tjetër;
- Identifikojë çështje të reja apo ato ndërvepruese, të cilat mund të trajtohen përmes një qasjeje më të koordinuar;
- Raportoje mbi mundësitë apo nevojat e strehimit të identifikuar në nivel kombëtar dhe lokal.

Raporti do të paraqitet në Njësinë e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj në Kryeministri. Gjithashtu do të prezantohet në një tryezë të rrumbullakët ku do të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve dhe organizatave në nivel qendror dhe vendor, si dhe specialistë të strehimit të njësive vendore.

5.3 Strukturat e përfshira në raportimin dhe konsultimin e raporteve të monitorimit

Institucionet dhe strukturat e përfshira në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së mbrojtjes sociale janë:

- Grupi ndër-ministror i Strehimit Social, i kryesuar nga Ministri i Zhvillimit Urban dhe me pjesëmarrjen e titullarëve të tjerë brenda kësaj ministrie dhe ministrive të tjera të linjës;
- Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara, që do të sigurojë përshtatjen e masave për arritjen e objektivave strategjike, duke marrë parasysh risqet që duhet të menaxhohen në vazhdimësi;
- Drejtoria Shërbimeve Urbane dhe Strehimit në MZHU dhe njësitë e saj apo të ndërvarura (NJQV, EKB, AKPT, ALUIZNI, Zyrat e Punësimit)

5.4. Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit me aktorët joqeveritarë

Strukturat sipas pikës 5.3 të këtij Kreu do të kryejnë vlerësimet që do të shërbejnë për raportimin dhe konsultimin me aktorët jo-qeveritarë. Raportimi do të jetë periodik një vjeçar dhe do të vlerësojë përmbushjen e masave të planit të zbatimit dhe treguesve të monitorimit. Raporti do të përfshijë kërkime nga ekspertë të pavarur dhe dokumente politike për të vlerësuar, nxjerrë përfundime dhe sugjeruar iniciativa të informuara (për çdo vit). Gjithashtu, do të mblidhen dhe analizohen të dhëna afat-gjata dhe sektoriale.

Aktorët joqeveritarë do të përfshihen përmes takimeve që do të realizohen çdo vit ku do të prezantohet progresi i strategjisë dhe do të diskutohen sfidat që janë hasur. Gjithashtu, aktorët joqeveritarë do të përfshihen në realizimin e analizave dhe vlerësime që janë parashikuar në përmbushjen e objektivave. Zbatimi i strategjisë do të mbështetet fort në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit edhe me aktorët joqeveritarë.

Tabela 5.3: Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Strehimit Social të Shqipërisë

Treguesit	Institucioni përgjegjës	Burimi	Baseline 2013-2015	Synimi 2020	Synimi 2025	Periodiciteti
Përqindja e familjeve rome dhe egjiptiane në nevojë që kanë përfituar nga programet e strehimit social.	MZHU	NJQV	10%	40%	80%	1 vjeçar
Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar nga programi i përmirësimit të infrastrukturës.	MZHU	NJQV	282 (23%)	458 (38%)	480 (39%)	1 vjeçar
Përqindja e njësive vendore të cilat kanë ngritur një sistem për grumbullimin e të dhënave dhe kanë përdorur evidencën e grumbulluar për përmirësimin e programeve të strehimit.	MZHU	NJQV INSTAT	0	40%	80%	1 vjeçar
Përqindja e aplikantëve që janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar nga specialistët e strehimit në njësitë vendore.	MZHU	NJQV	Nuk ka informacion	50%	80%	1 vjeçar
Përqindja e kërkesave të suksesshme për financim nga NJQV-të në vit.	MZHU	NJQV KM	90%	100%	100%	1 vjeçar
Përqindja e buxhetit qendror që caktohet për programet e strehimit social. (Sqarim: Nënkupton buxhetin e ministrisë)	MZHU KM	NJQV	19%	100%	100%	1 vjeçar
Përqindja e njësive vendore të cilat kanë financuar programe strehimi me burimet e veta.	MZHU	NJQV MÇV	Më pak se 5%	30%	50%	1 vjeçar
Numri i familjeve të dëbuara me forcë nga banesat.	MZHU	NJQV ALUIZNI DZHT	129	0	0	1 vjeçar
Përqindja e aplikantëve në nevojë që kanë patur akses në më shumë se një program social (për shembull përqindja e aplikantëve të papunë që kanë përfituar bonus strehimi si dhe janë punësuar).	MZHU MMSR MÇV KM	NJQV Zyrat e punesimit OSHC	Nuk ka informacion	20%	50%	1 vjeçar

Numri i trojeve të kaluara NJQV-ve për ofrimin e strehimit social në një vit.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	S'ka informacion	Në varësi të trojeve shtetërore të lira për strehim	Në varësi të trojeve shtetërore të lira për strehim	1 vjeçar
Numri i familjeve që kanë përfituar nga programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	0	Ne varësi te trojeve te vena ne dispozicion	Ne varësi te trojeve te vena ne dispozicion	1 vjeçar
Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i marrëveshjeve të partneritetit – publik-privat.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	0	Rreth 500	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	1 vjeçar
Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i marrëveshjeve të partneritetit – publik-privat-komunitet.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	0	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	1 vjeçar
Numri i familjeve të strehuara në ndërtesat e pashfrytëzuara (të përshtatura për qëllime strehimi).	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	0	Në varësi të kërkesave nga bashkitë	Në varësi të kërkesave nga bashkitë	1 vjeçar
Numri i projekteve të miratuara për përmirësimin e vendbanimeve të egjiptiane të konceptuara me pjesëmarrje të komuniteteve dhe të miratuara nga NJQV-të.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	13	50	100	1 vjeçar
Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i skemave të miratuara të strehimit me pjesëmarrje për grupet në pozita të pafavorizuara.	MZHU	NJQV Sektori privat OJQ OSHC	282	400	700	1 vjeçar

Përqindja e grupeve në pozita të pafavorizuara që kanë përfituar nga cilido prej instrumenteve financiare në muaj.	MZHU MF KM	NJQV	0	20%	60%	1 vjeçar
Sasia e fondeve të siguruara nga donatorët ndërkombëtarë.	MZHU NJQV	KNESS BKE KEKBE	0	79,620,000	6,700,000	1 vjeçar
Raporti i përfituesve (numri i përfituesve/aplikantëve) nga programi i financimit të projekteve të eficientës së energjisë në banesa.	MZHU	NJQV	57	163	170	1 vjeçar
Numri i përfituesve të kredive të lehtësuara që u është disbursuar kredia	MZHU	NJQV	3,894	5,000	7,000	3 muaj
Përqindja e grupeve në pozita të pafavorizuara që kanë përfituar nga subvencionimi i qirasë për objektet në pronësi të bashkisë.	MZHU	NJQV	S'ka informacion	Informacioni do të ofrohet nga njësite e qeverisjes vendore	Informacioni do të ofrohet nga njësite e qeverisjes vendore	1 vjeçar
Raporti i përfituesve të bonusit të qirasë (numri i përfituesve/aplikantëve) për banesat në treg të lirë të kontraktuara nga njësitë.	MZHU	NJQV	S'ka informacion	Informacioni do të ofrohet nga njësite e qeverisjes vendore	Informacioni do të ofrohet nga njësite e qeverisjes vendore	1 vjeçar
Përqindja e familjeve me kryefamiljare femër përfituese	MZHU	NJQV	18,7%	25%	50%	1 vjeçar
Përqindja e familjeve me një prind të vetëm përfituese	MZHU	NJQV	37,1%	50%	60%	1 vjeçar
Përqindja e familje të mëdha përfituese	MZHU	NJQV	25,5%	30%	35%	1 vjeçar
Përqindja e të moshuarve përfitues	MZHU	NJQV	25,4%	35%	50%	1 vjeçar
Përqindja e persona me aftësi të kufizuara përfitues	MZHU	NJQV	13,5%	25%	40%	1 vjeçar
Përqindja e çifteve në moshë të re përfitues	MZHU	NJQV	40,2%	45%	50%	1 vjeçar
Përqindja e familje që kanë ndryshuar vendqëndrim përfituese	MZHU	NJQV	28,6%	35%	40%	1 vjeçar

Përqindja e jetimëve përfitues	MZHU	NJQV	4,7%	30%	50%	1 vjeçar
Përqindja e emigrantë të rikthyer përfitues	MZHU	NJQV	27,9%	30%	30%	1 vjeçar
Përqindja e punëtorëve migrues përfitues	MZHU	NJQV	30,8%	35%	35%	1 vjeçar
Përqindja e azilkërkuesve përfitues	MZHU	NJQV	0	5%	5%	1 vjeçar
Përqindja e familjeve të oficerëve të rënë në krye të detyrës përfitues	MZHU	NJQV	0	10%	25%	1 vjeçar
Përqindja e viktimave të dhunës në familje përfituese	MZHU	NJQV	0	20%	40%	1 vjeçar
Përqindja e familjeve rome përfituese	MZHU	NJQV	37,2%	50%	70%	1 vjeçar
Përqindja e familje egjiptiane përfituese	MZHU	NJQV	11,2%	30%	50%	1 vjeçar
Përqindja e përfituesve të cilët marrin ndihmës ekonomike	MZHU	NJQV	22,8%	40%	60%	1 vjeçar
Grupe të tjera përfituese	MZHU	NJQV	35,9%	40%	50%	1 vjeçar

VI. REFERENCA

- Avokati i Popullit. (2012). Problematikat e komunitetit Rom gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2012, dhe trajtimi i tyre nga Avokati i Popullit. Tiranë, Shqipëri: Avokati i Popullit.
- Buckley, R. dhe Kalarickal, J. (redaktorë) (2006). *Thirty Years of World Bank Shelter Lending: What Have We Learned? (30 vjet huadhënie strehimi nga Banka Botërore: çfarë kemi mësuar?)* Uashington, D.K: Banka Botërore.
- ENHR (2007). *Pjesë të nxjerra nga grupet e punës*. Konferencë ndërkombëtare 25-28 qershor 2007. Rotterdam
- Gibb, K. (2002). Trends and Change in Social Housing Finance and Provision ëithin the European Union (Tendencat dhe ndryshimet në financimin për strehim social në Bashkim Evropian). *Housing Studies*, Vol. 17, Nr. 2, f.325-36, 2002.
- Hoek-Smit, M. (2006). *Housing Finance and the Role of Government: Incentives ëithout Distortions (Financimi për strehim dhe roli i shtetit: stimuj pa shtrembërime)*. Prezantim në Forumin FinMark në Johannesburg, 16 nëntor 2006.
- IHS (2006). Course package for social housing and housing finance (Materiale trajnimi për strehimin social dhe financimin për strehim). Rotterdam: Vendet e Ulëta.
- INSTAT. (2012). Censusi i popullsisë dhe banesave. Tiranë, Shqipëri: Instat.
- INSTAT. (2013). Shqipëria: Trendi i varfërisë, 2002, 2005, 2008, 2012. Retrieved July 20, 2014 from <http://www.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi-i-varferise-2012.pdf>
- OSBE. (2012). Raport nga seminari kombëtar për strehimin social. Retrieved September 15, 2014 from <http://ëëë.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/albania/technical%20papers/1917-PACA-TP-Shutina-july10.pdf>
- Pugh, C. (2001). The Theory and Practice of Housing Sector Development for Developing Countries (Teoria dhe praktika e zhvillimit të sektorit të strehimit për vendet në zhvillim), 1950-1999. *Housing Studies*, Vol. 16, Nr.4, f. 399-423, 2001.
- Renaud, B. (1999). The Financing of Social Housing in Integrating Financial Markets: a Vieë from Developing Countries (Financimi i strehimit social në tregjet e integruara financiare: vendet në zhvillim). *Urban Studies*, Vol. 36, Nr. 4, f. 755-773.
- Rust, K. (2008). *Housing Finance in Africa: analysis of housing finance sector studies (Financimi për strehim në Afrikë: analizë e studimeve të sektorit të financimit për strehim)*. Prezantim në Konferencën e Trustit Finmark 'Rritja e qëndrueshme e alternativave të mikrofinancimit për strehim në Afrikën subsahariane' në Dar es Salam, Tanzani. 19 maj 2008. Marrë në <http://www.finmark.org.za>.
- UNDP. (2014a). Social housing in Albania: A needs assessment. (Strehimi social në Shqipëri: vlerësimi i nevojave) Marrë më 26 shtator 2014 në adresën <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/needs-assessment-of-social-housing-in-albania/>
- UNDP. (2014b). Social housing in Albania: A situation analysis. (Strehimi social në Shqipëri: analiza e situatës) Marrë më 10 nëntor shtator 2014 në adresën <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/analysis-of-situation-of-social-housing-in-albania/>
- Ëhitehead, C., & K. Scanlon (redaktorë). (2007). *Social housing in Europe (Strehimi social në Evropë)*. LSE, Londër.